

# RAPORT VJETOR për 2017

---

i Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut Në  
Republikën e Maqedonisë

# **RAPORT VJETOR** për 2017

---

i Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut Në  
Republikën e Maqedonisë

# RAPORT VJETOR PËR VITIN 2017

## i Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë

### Botuesi:

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë përfaqësuar nga kryetari prof. Dr. Gordan Kalajdziev

### Redaktor:

Uranija Pirovska

### Lektor:

Ivana Kuzmanoska

### Dizajni grafik dhe shtypja:

Rellativ



Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë/Oendra LGBTI përmbështetjedhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyrimi pikëpamjet e Civica Mobilitas, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ose organizatat që e zbatojnë atë.

## PËRMBAJTJA:

HYRJE .....	5
GJYQËSORI .....	7
TRAJTIMI I BARABART .....	24
INSTITUCIONE TË MBYLLURA .....	43
DREJTSIA SOCIALE DHE KOHEZIONI .....	52
GRUPET E NDJESHME .....	55
MIGRANTËT, REFUGJATËT DHE AZILKËRKUESIT .....	64
NDIHMA JURIDIKE FALAS .....	76
LGBTI QENDRA E MBËSHTETJES .....	83
REKOMANDIME.....	88

# HYRJE

Vitin e kaluar e shënuan momente kyçe, që e forcojnë shoqërinë jonë, por në të njëjtën kohë ato janë rrezik për demokracinë, sundimi i ligjit dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut. Si kurrë më parë, u sulmuan organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë, hetojnë dhe raportojnë abuzimet dhe shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, praktikimin e qeverisjes dhe funksionimin e sistemit juridik. Për fat të mirë kjo për të mbyllur hapësirën për veprim e organizatave civile nuk dhanë rezultatet e dëshiruara për klientët porositës, pavarësisht nga fakti se organizatat civile ishin kritikisht të prirur për qeverinë e mëparshme ishin të nënshtruara në kontrole financiare nga Zyra e të Ardhurave Publike dhe nga policia financiare me kërkesë të Prokurorisë Publike. Kontrollat kryheshin vazhdimisht deri në Qershor të vitit 2017 dhe akoma jemi duke pritur për rezultatet përfundimtare nga hetimet.

Raporti përmbledh zhvillimet që ndodhin menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në dhjetor të vitit 2016, pas një periudhe të gjatë krize politike, në të cilën të drejtat e njeriut ishin brutalisht të shkelura. Gjithashtu shënon gjatësinë e procesit të ndryshimit që filloi pas zgjedhjeve dhe ndryshimit të Qeverisë. Raporti pasqyron situatën e të drejtave të njeriut në vend, masat e marra për mbrojtjen e tyre, por jep një përmbledhje të mënyrës se si shteti veproi në fushat që janë në fokusin strategjik të Komitetit, si nga aspekti i shërbimit për qytetarët, po edhe nga aspekti i legjislacionit dhe politikave.

Raporti shtjellon fushat në të cilat qytetarët i realizojnë të drejtat e tyre qytetare dhe politike, të drejtat sociale dhe ekonomike, institucionet e mbyllura dhe trajtimet policore, të drejtat e grupeve të cënueshme, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe komuniteti LGBTI. Në raport si pjesë të ndara janë trajtuar dukuritë që në pjesën më të madhe, kryesisht janë shkaqet e shkeljeve të të drejtave të njeriut-diskriminimi, gjuha e urrejtjes dhe veprimet e urrejtjes.

Duke mare parasysh se në periudhën raportuese, në historinë e Maqedonisë së pavarur ka ndodhur ndoshta akti më i vështirë i dhunës gjatë dorëzimit të pushtetit, ndërhyrja e dhunshme në shtëpinë e legjislativit

më të lartë, dhe dhuna fizike ndaj deputetëve nga shumica e re më 27 prill, një pjesë e veçantë e raportit përqendrohet në këto ngjarje, për të cilat Komiteti paraqiti një raport të veçantë në Prokurorinë Themelore Publike, ku konstatohen 28 vepra penale.

Pas formimit të Qeverisë së re të Republikës së Maqedonisë, filloj procesi i reformave, që përgjithësisht mund të vlerësohet si gjithëpërfshirës për shkak të përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile, si në përgatitjen e planit 3-6-9 dhe implementimin e propozimeve në dokumentin BLUPRINT, për reforma urgjente demokratike, ashtu edhe në grupet e punës që u formuan në ministritë përkatëse. Në raport ofrohet përmbledhje e procesit të reformave dhe zbatimin e tyre me rekomandime të përshtatshme për tejkalimin e dobësive në sistem.

Përveç shkeljeve të vërtetuara të të drejtave të njeriut, dhe konkluzioneve për politikën dhe praktikën e papërshtatshme në sjelljen e administratës shtetërore dhe autoritetet gjyqësore, Komiteti në raport jep rekomandimet e veta për tejkalimin e situatës në të gjitha fushat, në të cilat arritja dhe respektimi i të drejtave të njeriut mund të avancohen.

# GJYQËSORI

## ■ Reforma gjyqësore

Në fushën e gjyqësorit, viti 2017 e shënoi fillimin e reformave në gjyqësor, nga që duhet të theksohen: rritja e rolit, pjesëmarrja dhe kontributi i organizatave qytetare, duke përfshirë edhe Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në të gjithë procesin.

Gjetjet e Raportit nga grupi i ekspertëve i udhëhequr nga Reinhard Priebe që nga qershori i vitit 2015 ishin kryesisht të riafirmuara në raportin e dytë, i cili ofron vlerësim shtesë, rekomandime dhe udhëzime konkrete për proceset e reformës, të cilat u prezantuan në gjysmën e dytë të shtatorit të vitit 2017. Dhe në atë dominon përfundimi se akoma është i dukshëm mosfunksionimi të gjyqësori dhe institucionet shtetërore kyçe, në masë në të cilën pamundësohet zbatimi i mirëfilltë i ligjeve dhe kompetencave ligjore. Gjetjet e këtij raporti, si dhe përvoja shumëvjeçare në terren, në shumë masë drejtoi veprimtaritë e Komitetit të Helsinkit në procesin e reformës.

Veçanërisht e rëndësishme është që shpalljes të planit qeveritar për reforma, i njohur si Plani 3-6-9, i cili përmban përmbledhje të masave dhe aktiviteteve me prioritet, të nevojshme për zbatimin i reformave urgjente demokratike, i parapriu prezantimi i Propozimit të organizatave të shoqërisë civile për reforma urgjente demokratike, e cila ofroi rekomandime të përshtatshme për reformat në këtë fushë. Komiteti i Helsinkit dha kontributin e tij aktiv në përgatitjen e Strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor, së bashku me Planin aksionar shoqëruar për periudhën nga 2017 deri në 2022, e cila u miratua nga ana e Qeverisë në nëntor 2017.

Procesi i përgatitjes së Strategjisë, si dhe një pjesë e madhe e zgjidhjeve ligjore, ishte mjaft gjithëpërfshirëse, përmes së cilës pas publikimit të projekt-zgjidhjeve ligjore në shumicën e ndryshimeve që rezultuan nga Strategjia e Regjistri të Vetëm Nacional i Rregulloreve (ENER), ose përmes takimeve direkt dhe konsultime në Ministrinë e Drejtësisë, ju ishte dhënë

mundësi edhe organizatave të shoqërisë civile që me propozime dhe komente të tyre të kontribuojnë në përmirësimin e zgjidhjeve ligjore.

Sidoqoftë, një pikë e zezë në rrjedhën e të gjithë procesit, së pari shkaktoi përbërjen tepër të gjerë, e cila nuk krijoi supozime për funksionim efikas, dhe pastaj as mënyrën për thirrje të shpejtë të mbledhjeve të Këshillit për reforma të sistemit gjyqësor pranë Ministrisë së Drejtësisë, për të cilin rezultoi se ka qenë pamjaftueshëm dhe jo në kohë i njoftuar me të gjithë hapat që propozohen të ndërmerren, as që i ishte dhënë mundësia për të ndikuar në mënyrë autonome në rrjedhën e reformave duke vendosur agjendën e pyetjeve më të hidhëshme, dhe duke ofruar propozime të përshtatshme të ekspertëve dhe zgjidhje. Në të kundërtën, pas reagimit të një pjese të anëtarëve të Këshillit, të cilët treguan se anëtarësia e tyre ishte më shumë në drejtim të "aminimit" të tani më parapraakisht reformat e imagjinuara, dhe dorëheqjet e ofruara nga ana e tyre, ky Këshill ndaloi me punë.

Mbetet problematike se sa Këshilli i ri për monitorimin për zbatimin e strategjisë të Reformave në gjyqësor, i cili së shpejti u formua për të zëvendësuar Këshillin për reforma, me të cilin do të kryesojë Kryeministri Zoran Zaev dhe në të cilin anëtar do të jenë edhe Kryetarët e Gjykatës Supreme, gjykatës të Apelit në Shkup, gjykatës themelore Shkupi 1, si dhe Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokurorja publike speciale, do të ketë sukses që me të vërtetë të i udhëheq dhe kontrolloj proceset dhe të ketë rol korrigjues gjatë devijimit të tyre nga drejtimi i dëshiruar. Sidoqoftë, një pikë e ndritshme në trupin e sapo themeluar do të përfaqësojë anëtarësimi i një përfaqësuesi të Blueprint Justice Group-grupin për gjyqësor, në të cilën anëtare janë disa organizata të shoqërisë civile, përfshirë këtu edhe Komiteti i Helsinkit, të cilët me punën e tyre të vazhdueshme në fushën e gjyqësorit, me përvojë dhe ekspertizë të fituar, mund të jenë aktorë aktivë në proceset e reformave në përgjithësi.



## (Jo)varësi dhe (jo)paragjykimin në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publik

Gjatë vitit 2017 Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publik, vazhduan të zgjedhin gjyqtarë, përkatësisht prokurorë publik pa kurë fare ndryshime thelbësore, në mungesë të debatit, dhe pa shpjegim për (jo) përzgjedhjen e kandidatëve me numrin më të lartë të pikëve, ose, me të njëjtin numër pikësh.

Kritikë shtesë mund të parashtrohet edhe në lidhje me mënyrën e avancimit të gjyqtarëve, si dhe përzgjedhjen e kryetarëve e tyre. Në atë kuptim, zgjedhja e gjyqtarit Jovo Vangelovski për kryetarin e ri të vjetër të Gjykatës supreme në Mars të vitit 2017, duke marrë parasysh se ai, përmes përgjimeve të publikuara, ishte i kompromentuar, shkaktoi zemërim të mëdha.

Pas shumë situatave që në publik treguan punë skandaloze dhe të diskutueshme të kryetarit të mëparshëm të Gjykatës Themelore Shkupi 1, Vladimir Pançevski, në nëntor të vitit 2017 për kryetar i ri u zgjodh gjykatësi Ivan Xholev, e që hasi në jehonë pozitive në publikun profesional.

Sidoqoftë, edhe zgjedhja e fundit e gjyqtarëve nga këshilli gjyqësor, pas zgjedhjeve lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2017, solli në reagime të ashpra, kryesisht nga pjesë prej gjyqtarëve të paraqitur për këto pozicione, veçanërisht për shkak të faktit se për herë të parë, ishte anashkaluar neni i Ligjit për Gjykatat, dhe për gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Shkup, nuk u zgjodh kandidati me numër më të madh të pikëve. Kjo zgjedhje edhe një herë forcoi ndjenjën e mosbesimit në punën e Këshillit Gjyqësor, dhe për të satën herë krijoi dilema nëse fare mund të priten çfarë do reforma më serioze në punën e këtij trupi, në një situatë ku duket se vazhdon e njëjta praktikë në vendimmarrje jo transparente dhe e pashpjegueshme për çështjen për zgjedhje dhe avancim të gjyqtarëve.

Nëm lidhje me vërtetimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve, në dhjetor të vitit 2018 Këshilli Gjyqësor edhe një herë e shkarkoi gjyqtarin e apelit Mitrinovski, për të cilin Gjykata e Strasburgut vendosi se procedura për shkarkimin e tij në vitin 2011 nuk ishte e ligjshme. Këshilli veproi sipas ud-

hëzimeve të gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe me kërkesë të kërkuarit të përsëriti procedurën pasi që Gjykata e Strasburgut vendosi që parashtruesi i iniciativës për shkarkimin e Mitrovskit, Kryetari i Gjykatës Supreme, Vangelovski, gjithashtu mori pjesë duke votuar si anëtar i Këshillit, pra vendimi për të shkarkuar ishte e njëanshme. Me këtë, konsiderohet se dëmtimi është anuluar, dhe do të mundet të pritet mbyllja e ekzekutimit të këtij verdikti para Komitetit të Ministrave.

Formimi i këshillit për vërtetim të fakteve dhe fillimin e procedurës për përcaktim të përgjegjësisë për gjyqtar në vitin 2015 me detyrë që të veprojmë mbi ankesat kundër gjyqtarëve si trup i veçantë hetimor në drejtim të ndarjes në faza të veçanta në procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit (nisje procedure, kryerje hetimi dhe vendosje për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit), ende që në fillim, nga publiku profesional u vlerësua si një hap i panevojshëm, dhe kjo u vërtetua edhe në punën e tij të deri tanishme. Pasi që me planin "3-6-9", si dhe Strategjisë për reformën të sektorit gjyqësor, u parapara tërheqja e tij. Për fillimin e vitit 2018, kuvendi e paralajmëroi miratimin e Ligjit për përfundimin e vlefshmërisë të Ligjit për Këshillin për vërtetimin e fakteve dhe fillimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë për gjyqtar. Me këtë parashihet të vihet deri te kthimi i kompetencave për udhëheqje të procedurës disiplinore të Këshilli Gjyqësor, duke marrë parasysh të dhënat, vërejtjet dhe udhëzimet nga institucionet ndërkombëtare në pjesën e reformave të sistemit gjyqësor. Në përputhje me ndryshimin në pjesën e fillimit të procedurave kundër gjyqtarëve të caktuar nga ana e këshillit gjyqësor, do të insistohet që anëtarët e Këshillit Gjyqësor të cilët, si "prokurorë" kanë nisur procedurën, të mos përfshihen në vendimmarrje si "gjykatës". Zgjidhja e këtillë është në përputhje me pikëpamjet e Komisionit të Venecias dhe praktikën e vendosur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Edhe pas zgjedhjes të kryetarit të ri të Këshillit të Prokurorëve Publik, Kole Shteriev, nuk u ndien ndryshime serioze në funksionimin e Këshillit. Pavarësisht hapit pozitiv për të shkarkuar prokurorin publik të mëparshëm, Marko Zvrlevski, në gusht të vitit 2017, vetë procedura për zgjedhjen e prokurorit të ri, Ljubomir Joveski, ndryshe ish anëtar i Këshillit, nuk ishte plotësisht transparente, më para se numrin rekord të lartë të kandidatëve të paraqitur për këtë pozitë dhe mos disponueshmëria

e kriterëve konkrete në të cilat ishte bazuar zgjedhja e tij, gjegjësisht. dhënia e mendimit pozitiv nga Këshilli i Prokurorëve Publikë, pas së cilit ai më 25 dhjetor të vitit 2017 u zgjodh prokurori i ri publik shtetëror.

## ■ AKMIS Sistemi

Veprimet e disa gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave të veçantë, ishte vënë nën dyshim serioz në kontekstin për abuzime të mundshme të sistemit AKMIS për shpërndarjen automatike të lëndëve në gjykata, dhe veçanërisht në lidhje me shpërndarjen e lëndëve që dolën nga bisedat e përgjuara në juridiksionin e PSP, Të cilat për vendimmarrje ju përkitën vetëm disa gjyqtarëve nga Gjykata Themelore Shkup 1. Këto dyshime u shprehën fuqimisht edhe në raportin e dytë të ekspertëve të Pribe. Sipas tij, ka mundësi që ai të jetë manipuluar në disa mënyra: 1) shpërndarja e gjyqtarëve “të papërshtatshëm” në departamente të tjera kur është e nevojshme për të shpërndarë lëndë të ndjeshme; 2) largimi në pushim mjekësor ose leje tjetër gjatë periudhës së shpërndarjes të lëndëve të tilla nga ana e gjyqtarëve që dëshironin të shmangnin presionet; 3) mundësia e dallimeve në procedurë të cilat çohen sipas LPP-le të vjetër dhe të ri, të përdoren për të lehtësuar manipulimin me sistemin, si dhe 4) abuzimi i sistemit përmes qasjes të drejtpërdrejtë të personave të autorizuar, siç janë presidentët e gjykatave.

Duke marrë para sysh se asnjëherë nuk është bërë një mbikëqyrje e plotë nuk mbi funksionimin e AKMIS, në vjeshtë të vitit 2017 në Ministrinë e Drejtësisë ishte formuar një komision i veçantë për të hetuar abuzimet e mundshme të sistemit AKMIS. Pas përfundimit të inspektimit të funksionalitetit të IT sistemit-informatikë dhe mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të rregullores të punës të gjyqësorit në gjykata, përkatësisht në sistemin AKMIS për vitin 2016 dhe 2017 të zhvilluar në pesë dhe dhjetë tetor të këtij viti në Gjykatën Themelore Shkupi 1, më nëntë nëntor në Gjykatën e Apelit Shkup dhe më 17 nëntor në Gjykatën Supreme, u prezantua raporti përfundimtar, sipas të cilit veç më do të duhet të vepronet në drejtim i përcaktimit të përgjegjësisë konkrete individuale për abuzimet dhe tejkalimin e dobësive të konstatuara në të ardhmen.

## ■ Prokuroria speciale publike

PSP edhe në tremujorin e parë të vitit 2017 ishte e pamundësuar që në tërësi dhe pa pengesa në ekzekutimin e plotë ligjor të kompetencave për procesimin e të gjitha që dolën nga të ashtuquajturat “Bomba”, por edhe mungesa e nevojshme e bashkëpunimit me strukturat më të rëndësishme shtetërore. Kjo periudhë ishte shënuar me opstrukcione dhe mos bashkëpunimi me PSP nga organet kompetente shtetërore, siç është Ministria e punëve të brendshme, por edhe duke bllokuar proceset në gjykatën themelore Shkup 1. Përveç asaj, ishte bërë edhe ndëshkim i prokurorëve nga PSP me gjoba prej 2,000 euro, për shkak të gjoja “mos respektit elementar të gjykatës» gjatë seancës gjyqësore të mbajtur në rastin e dhunës në Komunën e Qendrës.

Të dukshme ishin edhe rishpërndarjet masive të gjyqtarëve në Gjykatën Themelore Shkupi 1, të cilat filluan në kohën e kryetarit të mëparshëm, Pançevski, për të vazhduar në shkurt të vitit 2017, kur u.d. kryetarja Tatjana Mihajlova shpërndau njëzet gjyqtarë nga departamenti penal në atë të kundërvajtjes, pa asnjë konsultim me ta, ndër të cilët ishin edhe disa nga gjyqtarët e rrallë që morën vendime pozitive për kërkesat e PSP për kërkim ose masën paraburgim. Kryetari i sapoemëruar i gjykatës, Stojançe Ribarev, vazhdoi me praktikë të ngjashme dhe solli një orar vjetor të ri, kontrovers, të punës për vitin 2017, por gjërat, deri diku u përmirësuan pas zgjedhjes së Ivan Xholevit për kryetar, i cili solli orar të ri në dhjetor të vitit 2017, me të cilin stafi me përvojë u kthye për të gjykuar lëndët e krimit të organizuar. Në çdo rast, “rotacionet” e tilla të shpeshta të gjyqtarëve nga një departament në departament tjetër, do të kenë një efekt të dëmshëm mbi zhvillimin e procedurave penale të iniciuara nga PSP. Rishpërndarje të ngjashme ndodhën edhe në Gjykatën Supreme, ku ish-kryetarja Lidija Nedelkova ishte vendosur në departamentin për gjykim në afat të arsyeshëm, pavarësisht përvojës e saj shumëvjeçare në materien penale.

Ndër opstrukcionet e shumta, Gjykata Themelore Shkupi 1 refuzoi të lëshojë urdhër për kërkim të sistemeve kompjuterike në operatorin e

telekomunikacionit, gjë që u shpjegua me gjoja paqartësi dhe pasaktësi të kërkesës. Në të njëjtën kohë, numri i madh i propozimeve të paraqitura për shqiptimin e masës së paraburgimit për personat e dyshuar për veprime që vijnë nga materialet e përgjuara, ishin të refuzuar, veçanërisht kur bëhej fjalë për ish funksionarët e lartë shtetëror. Gjithashtu nga ana e gjykatës ishte lëshuar vetëm një urdhër për kërkim për procedurën e hetimit në lëndën "Titanik", ndërsa të gjitha kërkesat tjera për lëshimin e urdhrave të kërkimit për funksionarët e mëparshëm dhe të tanishëm, ishin të refuzuara.

Veçanërisht kontroverse ishin vendimet e Këshillit të gjykatës supreme të 26 korrikut të vitit 2017, duke hedhur poshtë ankesat të mbrojtësve të Goran Grujovskit dhe Nikolla Boshkovskit në rastet "Synimi" dhe "Kalaja", të cilave u referohen përgjimi i paligjshëm dhe shkatërrimi i paligjshëm i pajisjeve në DSK, dhe ishi të konfirmuar vendimet e Gjykatës së Apelit të Shkupit për përcaktimin e masës të paraburgimit prej 30 ditësh. Me këtë ishte bërë precedan dhe u pranua veprim i pezulluar i ankimit, me të cilën u la hapësirë për ikje të të pandehurve, për shkak të së cilës gjithashtu kërkohej përgjegjësia e gjyqtarëve për veprime të tilla, që paraqesin një anashkalim të dukshëm të ligjit në dëm të drejtësisë.

Opstrukcionet gradualisht u zvogëluan në gjysmën e dytë të vitit 2017. Dhe në raportin e katërt për punën e PSP-së për periudhën nga 15 marsi deri më 15 shtator të vitit 2017, vërehet se ajo çfarë e dallon këtë periudhë nga të tjerat, është pikërisht paraqitja e akuzave për shumicën e parashtresave të hapura hetimore, gjegjësisht se gjithsej janë parashtruar 18 aktakuza për 19 raste kundër 120 personave për 168 vepra penale, nga të cilat në periudhën e raportit, janë hapur shtatë procedura të reja hetimore kundër gjithsej 25 persona fizik, dhe janë ndërmarrë veprime hetimore kundër katër persona juridik.

Sidoqoftë, trajtimi i ndryshëm i materialeve të përgjuara të përfshira në të ashtuquajturat "Bomba" nga gjykatat vendase në procedurat e iniciuara nga PSP i vë në pikëpyetje, paanësinë në drejtësi ndarje, si dhe sigurinë juridike.

Gjykata e Apelit Shkup, dy herë lejoi provat të marra nga materialet e përgjuara për tu trajtuar si prova në procedurën penale, edhe atë në rastin e Komunës Qendër, si në rastin "Trista", e cila i pranoi ankesat e PSP

dhe i ndryshuan vendimet e Gjykatës Themelore Shkup 1, me të cilat, provat në këto raste ndahen nga regjistrat si prova të marra në mënyrë të paligjshme.

Nga ana tjetër, Gjykata Themelore Shkupi 1 në shtator të vitit 2017 i ndau bisedat e përgjuara nga provat në rastin “Toplik”, “Tenderi” dhe “Tortura” me shpjegimin se ishin të marra në mënyrë të paligjshme dhe me shkelje të të drejtave dhe lirive të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, e cila i bën ato të papërdorshme në procedurat përkatëse.

Më në fund, pavarësisht nga trendët pozitive, deri në fund të vitit 2017, Statusi i mëtejshëm i Prokurorisë Speciale Publike mbeti i pasigurt kundër propozimeve për shndërrimin e saj në një njësi të posaçme të PPRM e cila do të kishte një mandat të zgjatur për të vepruar edhe në raste të tjera të profilit të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsioni, që krijojnë pasiguri nga aspekti i realizimit të plotë të kompetencave të saja në periudhat e mëtejshme.

## ■ Prokuroria publike

Edhe gjatë vitit 2017, Komiteti i Helsinkit vazhdoi të paraqesë padi penale në Prokurorinë Publike dhe të kërkon që ajo sipas detyrës zyrtare të fillojë procedurat për rastet e shkeljeve së të drejtave dhe lirive të njeriut. Por akoma ekziston një pasivitet i madh në veprim dhe mbyllje të këtij institucioni, i cili pasohet nga mosrespektimi i afateve të përcaktuara ligjërisht me Ligjin për Procedurën Penale, i cili parashikon një periudhë kohore prej 6 muajsh, për tu zbatuar procedura e hetimit, e cila fillon të rrjedhë nga dita e sjelljes të urdhëresës.

Për më tepër, në shumicën e rasteve, në të cilat tregohet për tejkalimin e kompetencave të policisë dhe përdorimi i tepruar i forcës nga policia, si dhe për gjuhën e urrejtjes dhe veprimet e urrejtjes, por edhe në të gjitha rastet e tjera, nuk ka asnjë përgjigje për rrjedhën e hetimit, ose, akuzat penale refuzohen me arsyetimin, se nuk bëhet fjalë për vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Duke pasur parasysh praktikën e vazhdueshme të mosrespektimit

të hetimeve efikase, në rastet e sjelljes së keqe të zyrtarëve të autorizuar të policisë, është paralajmëruar finalizimi i shpejtë i përpjekjeve të ndërmarra me iniciativë të Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurorinë Publike dhe Avokatin e Popullit, në drejtim të vendosjes mekanizëm të jashtëm, të pavarur për mbikëqyrjen e veprimit jo ligjor të policisë dhe përdorimin e tepruar të forcës nga ana e policisë. Është paralajmëruar vendosja e shpejtë e një axhende parlamentare e një pakete ndryshimesh legjislative në shtatë ligje, përmes së cilës duhet të sigurohet korniza ligjore për krijimin e këtij mekanizmi (Ligji për Policinë, Ligji për Punët e Brendshme, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve, Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për shërbimin e Prokurorisë Publike, Ligji për Prokurorinë Publike dhe Ligji për gjykatat). Me formimin e "Prokurorisë Plus", gjegjësisht të një njësie të posaçme brenda PPRM, dhe një njësie në zyrat e Avokatit të Popullit, për të cilat, afati për themelimin e tyre, është 60 ditë pas formësimit të kornizës ligjore, do të duhej të rritet efikasiteti në trajtimin i rasteve të tilla, dhe të parandalohen shkelje të ngjashme të Konventës, por edhe më tutje mbeten edhe një sërë hapash të tjera që duhen ndërmarrë me qëllimin që së fundmi ky mekanizëm të funksionuar.

Mosnjohja e elementeve të gjuhës së urrejtjes nga Prokuroria Publike në një sërë rastesh mundësoi përsëritje të mëtutjeshme të veprave, veçanërisht në rastin e Milenko Nedelkovskit, lidhur me të cilin veprimi para PPRM, akoma është në vazhdim, por pa ndonjë rezultat më konkret. Në të njëjtën kohë, në vitin 2017 kallëzim penal ishte ngritur edhe kundër Kryetarit të mëparshëm të Komunës të Karposhit dhe Kryetar i partisë GROM, lidhur me gjuhën e tij të drejtpërdrejtë të urrejtjes, drejtuar anëtarëve të komunitetit LGBT të paraqitur në suaza të një paraqitjeje të tij publike, në kulmin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale në tetor të vitit 2017, por as edhe në këtë rast, Prokuroria nuk dha një përgjigje konkrete në lidhje me kallëzimin penal të ngritur.

Seleksionimi dhe anshmëria në punën e PPRM në shprehje erdhën përmes disa procedimeve që ishin zhvilluar kundër kryetarit të mëparshëm të Gjykatës Themelore Shkupi 1, Pancevski, kryetarit të Komunës Qendër, Zhernovski, si edhe kundër disa të tjerëve, bartës të funksioneve publike, veçanërisht nga aspekti i tajmi ngut në të cilin ishin ngritur hetimet dhe mënyra e zbatimit të tyre, që ngre dyshime në pikëpamje

të mundësisë të instrumentalizimit politik, dhe e zvogëlon edhe ashtu shkallën e ultë të besueshmërisë së këtij institucioni në publik.

Në krye të kësaj,, në një periudhë më të gjatë kishte mungesë të veprim-it aktiv të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit në lidhje me zhvillimet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill të vitit 2017, kur kishte një hyrje masive në ndërtesën e parlamentit, të një turme të madhe protestuesish, në mesin e të cilëve, edhe njerëz me dosje të dyshimtë kriminale, të cilët mbanin kapuç në kokë dhe përmes sjelljes agresive, në rrezik e sollën jetën e një pjese të deputetëve.

Autorët e identifikuar dyshoheshin për tre lloje të veprave penale, edhe atë pjesëmarrje në turmë që do të pengojë personin zyrtar në kryerje të veprimit zyrtar, pjesëmarrje në turmë që do të kryejë vepër penale dhe do të shkaktojë rrezik të përgjithshëm. Në të kundërt, raporti i posaçëm për këto ngjarje i përgatitur nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut tregoi se në fakt, u kryen gjithsejtë 28 vepra penale të ndryshme të rënda, që janë të parashikuara nga Kodi Penal dhe ai kishte për qëllim që të i ndihmojë autoritetet kompetente gjyqësore, dhe mbi të gjitha PPRM në kualifikimin e këtyre veprave penale.

Duke pasur para sysh se këto ngjarje kanë ndodhur, edhe pse ka dështuar sistemi i sigurisë, në fakt, në këtë rast konkret, ishin të ndihmuar nga mosveprimi i zyrtarëve policor, e njëjta gjë ishte e qartë si rezultat i një urdhri të paligjshëm dhe keqpërdorimit të pozicionit zyrtar. Në atë kuptim, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, bëri thirrje për përgjegjësinë e autorëve, por edhe të eprorëve urdhërues të këtyre ngjarjeve.

Deri në një kthesë të plotë në veprimin e deriatëhershëm të Prokurorisë Publike erdhi me arrestimin e 36 personave, në mesin e të cilëve edhe disa deputetë, imuniteti i të cilëve ishte hequr, çfarë ndodhi më 28 nëntor vitit 2017, pasi PTHPNKOK lëshoi urdhër për të kryer proces hetimi ndaj 36 personave për shkak të dyshimit të arsyeshëm për kryerje vepër penale. Për të gjithë ata ishte kërkuar përcaktimi i masës paraburgim, por është e habitshme që, për dallim nga inkriminimet e mëparshme “të lehta” që lidheshim me pjesëmarrje në turmë, kësaj here të gjithë këta persona u ngarkuan me kërcënim terrorist të rendit kushtetues dhe sigurinë, vepër për të cilën neni 313 i Kodit Penal parashikon një dënim me



burgim të paktën dhjetë vjet. Kjo hedh dyshime shtesë mbi pavarësinë dhe qëndrueshmërinë në veprim të autoriteteve të prokurorisë publike, në drejtim të fluksit të periudhës e gjatë, shtatë-mujore nga ngjarjet deri në marrjen e veprimeve më konkrete për kryerjen e procedurës hetuese, si dhe duke pasur parasysh peshën e inkrimimeve.

Në përgjithësi, veprimi i Prokurorisë mund të vlerësohet si jashtëzakonisht joefikas dhe jo transparent, pra me çka ajo akoma dështon në rolin e saj për të qenë mbrojtës i të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

Shfuqizimi i Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjes të lartësisë të gjobës.

Pas kritikave të shumta që ka hasur që prej sjelljes së tij, veçanërisht nga aspekti që e prish parimin e vlerësimit të lirë gjykatës si garanci e pavarësisë, Gjykata Kushtetuese në vitin 2017 përfundimisht solli vendim me të cilin e shfuqizon Ligjin për Përcaktimin e Llojit dhe masës së lartësisë së gjobës, me shpjegimin se ky ligj, seriozisht ka ndërhyrë në pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe e ka shkelur parimin e ndarjes së pushteteve, dhe me të është bërë përzjerje e pushtetit ligjdhënës dhe pushtetin gjyqësor, i cili duhet të jetë i pavarur. Në vendim thuhet se ligji është në kundërshtim me lirinë e paraparë ligjore të vlerësimit të provave dhe bindjes të lirë të gjykatësve, i cili u formalizua me të, me që nuk i është kushtuar vëmendje individualizimit të dënimit.

Ky ligj është kritikuar edhe më parë edhe nga aspekti i asaj se çon në pranimin e shpeshtë të fajit që në seancën kryesore; zbatimin e shpeshtë të procedurave për lëshimin e një urdhër gjobimi; dënim më të butë për vepra penale më të rënda; dënim më të rreptë për vepra penale më të lehta; pabarazia e praktikës, etj. Në bazë të asaj, rekomandoheshin ndërhyrjet e duhura ligjore, përfshirë shfuqizimin e plotë të këtij ligji, si dhe ndryshimet të përshtatshme në nenin 39 paragrafin 3 të Kodit Penal. Një herë gjatë seancës së 40-të të mbajtur në nëntor 2017.

## ■ Ligji për amnisti

Pasi që gjatë seancës së 40-të të mbajtur në nëntor të vitit 2017, Qeveria shqyrtoi dhe miratoi projektligjin për amnisti, u hap rruga për shqyrtimin e tij të mëtejshëm dhe adoptimin e tij, e që pritet në fillim të vitit 2018.

Në propozim-tekstin e ligjit theksohet në rëndësinë e të drejtës të faljes (mëshirës) të shtetit ndaj kryesve të veprave të dënueshme, në mënyrë që të mos ndiqen penalisht, ose personave të dënuar tashmë për t'u falet ose zbutet dënimi. Në të njëjtën kohë, theksohet se qëllimi i miratimit të këtij ligji konsiston si në risocializimin e autorëve me qëllim që në të ardhmen të mos shfaqet si kryerës veprave penale, për çka edhe lidhet fillimi i paralajmëruar i aplikimit të provës, si dhe në parandalimin e gjendjeve negative dhe ndalimin e infeksionit kriminal, të cilët do të rezultonte nga mbingarkesa dhe kushtet e këqija dhe çnjerëzore në institucionet dënuese dhe përmirësuese në mënyrën në të cilën ato janë vlerësuar nga organizatat ndërkombëtare, dhe në lehtësimin financiar të buxhetit, për sa i përket mirëmbajtjes të popullsisë së burgjeve.

Me këtë ligj të shkurt përcaktohen kategoritë e personave që do të lirohen nga vuajtja e dënimit me burg, me çka precizohet se personat e dënuar të cilëve u është caktuar dënimi me burg deri në gjashtë muaj, tërësisht janë të liruar nga vuajtja të dënimit, personat e dënuar me burgim me më shumë se gjashtë muaj lirohen nga vuajtja e 30% të totalit të dënimit me dënim të shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa personat e dënuar me vendim të formës të prerë të cilët janë dënuar me një dënim të vetëm, lirohen nga vuajtja e dënimit të vetëm me burgim për 30% në pjesën e dënimit individual të përcaktuar paraprakisht e të përfillura nga amnistia. Në propozim gjithashtu precizohet se nëse dënimi i vetëm me burgim, është dënim i vërtetuar për burgimi për vepër penale e cila nuk i nënshtrohet amnistisë, i dënuari do të lirohet nga vuajtja e dënimit për 30% vetëm në pjesën të dënimeve individuale të përcaktuara më parë të përfillura nga amnisti.

Neni 3 qartë thotë se amnistia nuk vlen për personat e dënuar me burgim të përjetshëm, dhe i rendit veprat të cilat do të jenë të përjashtuara nga procesi, si që është vepra penale vrasje (neni 123 nga Kodi Penal);

veprat kundër zgjedhjeve dhe votimeve (nenet 158-165-c të KP), veprat kundër lirive të gjinisë dhe moralit gjeneral (nenet 186, 187, 188, 189, 191, 193, 193-a, 193-b dhe 194 të KP); veprat kundër shtetit (neni 305-327 të GJK); veprat kundër rendit publik (neni 394-a-394-d, i KP); si dhe veprimet kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare (art403-418-a dhe nga 418-c deri në 422 të KP).

Në të njëjtën kohë, parashikohet që procedura për aplikimin aplikimit të këtij ligj, për personat e dënuar që gjinden në mbajtjen e vuajtjes dënimit me burgim, do të vendoset sipas detyrës zyrtare nga institucioni ndëshkues dhe edukues, ndërsa për ata persona që nuk kanë filluar mbajtjen e vuajtjes të dënimit me burg - e inicion gjykata që e ka sjellë aktgjykimin e shkallës të parë, sipas detyrës zyrtare, me kërkesë nga prokurori publik ose me kërkesë të personit të dënuar. Gjithashtu parashikohet edhe e drejtë e përshtatshme për të ankuar kundër vendimit për amnisti brenda 24 orëve, nga marrja e vendimit, të cilën mundet të e paraqesë personi i dënuar dhe personi i cili, në favor të personit të dënuar mund të paraqesë ankesë.

## ■ Luftë kundër korrupsionit

Në periudhën raportuese, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut vazhdoj të monitorojë zhvillimet në lidhje me korrupsionin, si përmes procedurave gjyqësore të iniciuara dhe të zhvilluara në këtë fushë, ashtu edhe përmes rasteve të raportuara tek ekipi juridik i Komiteti, në suaza të programit së ofrimit e ndihmës juridike falas.

Hap shtesë në drejtim të forcimit të vullnetit politik për luftimin e korrupsionit dhe mbajtjen e bartësve të funksioneve më të larta politike përgjegjëse për çdo lloj të praktike të paligjshme ishte bërë përmes ngritjes të iniciativës nga ana e Komiteti për nënshkrimin e Deklaratës për Luftë kundër korrupsionit.

Gjegjësisht, në kuadër të kremtimit të ditës ndërkombëtare kundër korrupsionit (9 Dhjetor) dhe ditës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (10 Dhjetor), Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut organizon një ngjar-

je, në të cilën nga ana e përfaqësuesve më të lartë të pushtetit qendror dhe lokal, si dhe nga udhëheqësit politikë të partnerëve të koalicionit në qeveri, ishte nënshkruar një deklaratë e përbashkët. Përmes kësaj deklarate ata i shprehën angazhimet e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe u angazhuan për tolerancë zero ndaj korrupsionit në qeveri si edhe në partitë e tyre politike.

Deklarata kundër korrupsionit ishte dorëzuar deri te të gjithë ministrinë dhe organizatat qytetare, pas së cilës e nënshkruan 61 bartës të i funksionit publike, me ç'gjë e shprehën angazhimin e tyre të hapur për luftë kundër korrupsionit. Lista e nënshkruesve i përfshiu Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë, Ljubomir Joveski, Prokuroren Publike për Ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat dalin nga përmbajtja e ndjekjes të paligjshme të komunikimeve, Katica Janeva, 18 ministra dhe një zëvendës ministër në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Kryetari i qytetit të Shkupit dhe kryetarët e 35 komunave.

Sidoqoftë, Komiteti i Helsinkit përmes aktiviteteve të tija të rregullta, vazhdon të investojë përpjekje shtesë në këtë drejtim, si që janë, monitorimi i situatave të gjyqësori dhe sigurimi i rregullt i ndihmës juridike falas të zyrat e tij, veçanërisht duke i pasur para sysh treguesit që tregojnë efektin vdekjeprurës të korrupsionit mbi të drejtat dhe liritë e njeriut.

## Përfaqësimi strategjik para gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut

Puna shumë vjeçare e Komitetit të Helsinkit në fushën e përfaqësimit strategjik përmes paraqitjes të aplikimeve individuale në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në e tekstin e më tutjeshëm: "GJEDNJ" ose "Gjykata") jep fryte në vitin 2017. Gjegjësisht, gjatë vitit nga Gjykata ishin sjellë dy aktgjykime në favor të ankuesve, të cilët ishin përfaqësuar nga ana e Komitetit të Helsinkit, dhe në të dy gjykimet ishte gjetë shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e më-

tutjeshëm si “KEDNJ” ose “Konventa”). Bëhet fjalë për aktgjykimet në çështjet “Karajanov kundër Republikës të Maqedonisë» dhe “Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-ortodokse e Patriarkanës së Pejës)”.

## **Karajanov kundër RM (aplikimi nr. 2229/16) aktgjykim nga 6 prilli 2017**

Pas vendimit në rastin e Trendafil Ivanovski në 21 janar 2016, ky është rasti e dytë në të cilën GJEDNJ merret me lustracionin në Republikën e Maqedonisë. Këtë herë aplikimi ishte ngritur në lidhje me procedurën e lustrimit të aplikantit, një ish-gazetar dhe redaktor gazete, i cili me vendim të komisionit për Verifikimin e Fakteve nga viti 2013 (“Komisioni i Lustracionit”) ishte shpallur për bashkëpunëtor të shërbimeve sekrete, gjë që më vonë ishte konfirmuar nga aktgjykimet e Gjykatës Administrative dhe asaj të Lartë Administrative. GJEDNJ përcakton shkeljen e të drejtës së tij për një gjykim të drejtë, sepse ai nuk ka pasur mundësi që në mënyrë efektive të e prezantoj rastin e tij, dhe dy gjykatat që kanë vepruar në mosmarrëveshjen administrative të iniciuar nga ai, nuk e kanë ushtruan kompetencën e tyre të plotë në pikëpamje e vërtetimit të fakteve dhe zbatimit i ligjit, gjegjësisht seancë meritore të lëndës, dhe as që kanë ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mos mbajtjen e një seance verbale në prani të kërkuarit në cilën do fazë të procesit, duke marrë para sysh se fjala është për çështje diskutabile faktike dhe juridike, që thjesht nuk kanë qenë të natyrës teknike. Në veçanti gjykatat administrative dështuan të japin shpjegim thelbësor në lidhje me vërtetësinë e provave kundër tij dhe argumenteve të tij se dosjet mbi të cilat është bazuar vendimi i Komisionit, plotësisht i referohet një person tjetër, domethënë, fjala ka qenë për një identitet të gabuar, edhe pse vepronin me juridiksion të plotë.

Në të njëjtën kohë, Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 8 të Konventës (e drejta për respekt të jetës private dhe familjare) për shkak të publikimit të vendimit të Komisionit të Lustracionit në faqen e internetit të Komisionit që në ditën e miratimit të tij, gjegjësisht, para se të bëhet përfundimtar dhe i plotfuqishëm. Në vendimmarrjen e tij, GJEDNJ veçanërisht parasysh merr atë se publikimi i tillë nuk i shërben asnjërës prej qëllimeve legjitime për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, sigurisë publike,

mirëqenies ekonomike të vendit dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si dhe mosha 77-vjeçare e kërkuesit, fakti se ai nuk ishte bartës, as kandidat për post publik, pikëpamja e Komisionit të Venecias pranë Këshillit të Evropës nga 17 dhjetori i vitit 2012 se dispozita ligjore për publikimin e emrave të personave të lustruar para plotfuqishmërisë së vendimeve për lustrim është në kundërshtim me nenin 8 të Konventës dhe mundet të ketë pasoja të dëmshme në reputacionin e personit të cilat nuk mund të hiqen me korigjim të mëvonshëm, si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, U. Nr. 42/2008, nga 24 marsi viti 2010.

Kërkuesit iu gjykuan 4,500 EUR si kompensim për dëm jo material, si dhe 1000 euro shtesë për të mbuluar shpenzimet dhe të dhënat e procedurës.

Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit e Patriark anës së Pejës), nr. i aplikimit 3532/07, aktgjykim i datës 16 nëntor të vitit 2017.

Me këtë aktgjykim të GJEDNJ ishte konstatuar shkelje e nenit 11 (liria e tubimit dhe shoqërimit) në lidhshmëri me nenin 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë) nga Konventa për shkak të refuzimit të autoriteteve kompetente për t'u regjistruar Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (POA) si një bashkësi e veçantë fetare. GJEDNJ konstatoi se kërkesat e POA për t'u regjistruar u refuzuan për shkaqe formale dhe me dy arsye të tjera: sepse shoqata aplikuese është formuar nga një kishë apo shtet i huaj, si dhe emri i propozuar i saj ishte problematik, veçanërisht për sa i përket asaj se ishte shumë e ngjashme me emrin e KOM-Kryepeshkopata e Ohrit, e cila ka të drejtë historike, fetar dhe morale, për të përdorur këtë emër në vazhdimësi.

Gjykata në analizën e saj, i njeh hapësirë të gjerë shtetit për vlerësim në marrëdhëniet e tij me bashkësitë fetare dhe e thekson nevojën për t'u pajtuar interesat e grupeve të ndryshme fetare që bashkëjetojnë në një shoqëri demokratike, me gjithë atë duke mbetur neutral dhe i paanshëm. Ai vuri në dukje se arsyet e dhëna në aspektin mangësive formale për regjistrim nuk ishin as relevante dhe as të mjaftueshme. Për më tepër, Gjykata nënvizoi se autoritetet nacionale duhet të kushtojnë vëmendje të veçantë për të siguruar që opinioni publik kombëtar të mos mbrohet në dëm të pikëpamjeve të pakicave, sado jopopullor të jetë roli i

autoriteteve në një situatë konflikti midis ose brenda grupeve fetare nuk është për të hequr shkakun për tension duke eliminuar pluralizmin, por të sigurojnë që grupet kundërshtare të tolerojnë njëra-tjetrën. Gjykata përsëriti se masat parandaluese nuk mund të justifikohen për të shtypur lirinë e tubimit dhe shoqërimit, dhe në asnjërin stadium të procedurës të brendshme nuk është specifikuar se aplikuesi ka përkrahur përdorimin e dhunës ose çfarëdo mjeti tjetër antidemokratik për të arritur qëllimet e tija. Prandaj nga këtu, u konkludua se mënyra në të cilën autoritetet brendshme nacionale refuzuan të njohin shoqatën e aplikantit, nuk ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, dhe përfaqëson shkelje të nenit 11 të Konventës, interpretuar në dritën e Nenit 9.

Përndryshe, shoqatë së aplikantit iu gjykuan 4,500 euro si kompensim të dëmit jo material, si dhe pagesë të shpenzimeve dhe harxhimeve në vlerë prej 5,000 euro.


# TRAJTIM I BARABARTË

## ■ Diskriminim

Gjatë vitit 2017, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, vazhdimisht e ndiqte situatën në fushën e diskriminimit në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, me qëllim për parandalimi dhe mbrojtje nga diskriminimi, duke siguruar ndihmë juridike për viktimat nga diskriminimi, përfaqësimi gjyqësor në rastet strategjike, duke informuar publikun për rastet e diskriminimit dhe trajtimi dhe efikasiteti i mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi. Me përjashtim të kërkesave të marra për raste të diskriminimit, Komiteti, gjithashtu mërej edhe me çështje të cilat i regjistron përmes monitorimit të mediave, rrjeteve sociale, njoftimeve për punësim dhe përmes monitorimit të gjendjes në shoqëri, politikat dhe praktikat ekzistuese.

Gjithsej 58 raste të diskriminimit ishin dokumentuar gjatë vitit të, të cilat pasqyrojnë probleme sistematike për Romët, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë, veçanërisht gratë nga bashkësitë etnike të pakicave.

Sipas të dhënave statistikore, është e qartë se shumica e rasteve kanë të bëjnë me diskriminimin e bazuar në seks dhe gjini, aftësinë e kufizuar dhe përkatësinë etnike.






Në lidhje me fushat në të cilat është kryer diskriminimi, më të zakonshmet janë marrëdhëniet e punës, dhe menjëherë pas tyre janë, kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe aksesit në mallra dhe shërbime,

Në pjesën e ndërgjegjësimit për ekzistencën e diskriminimit, shoqatat e qytetarëve, ende janë më aktivet në këtë seksion. Përmirësime të reageimeve dhe raportimeve të situatës me diskriminimin në publik ka nga ana e Avokatit të Popullit dhe nga Komisionit për Mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa institucionet e tjera mbeten pasive në këtë pjesë.

Shfaqje statistikore e reageimeve të regjistruara nga institucionet në rastet e diskriminimit.



## ■ Diskriminim në marrëdhënie pune

Edhe në këtë fushë ishin zbuluar raste të diskriminimit edhe në qasjen deri në punësim dhe përfundimin e marrëdhënies të punës. Janë regjistruar raste të zbatimit të ndryshëm të dispozitave nga marrëveshja kolektive për ekonominë, të cilat kanë të bëjnë me rekursin e pushimit vjetor, të cilin gratë që shfrytëzojnë pushim të lehonisë vendosen në disavantazh. Në raste të ndryshme individuale inspektorati konsideron se për shkak të shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, nuk ju takon rekurs për pushim vjetor, Gjegjësisht pushimin e lehonisë e trajton si ndërprerje të marrëdhënies të punës Vetë termi pushim i lehonisë, tregon se bëhet fjalë për mungesë, e jo ndërprerje të marrëdhënies të punës dhe assesi nuk lejohet që të interpretohet në mënyrë arbitrare. Interpretimi i këtillë dhe zbatimi i ndryshëm i dispozitave për rekurs për pushim vjetor janë në kundërshtim me parimet për mos diskriminim dhe mundësi të barabarta dhe trajtimi i burrave dhe grave, duke pasur parasysh se shumica e punëtorëve që shfrytëzojnë pushim lehonie janë gra. Komiteti i Helsinkit kërkoi nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të barazojë interpretimin e dispozitave të rekursit që në të ardhmen të mos ketë shkelje të të drejtave të marrëdhënies të punës për gratë që shfrytëzojnë pushimin e lehonisë.

Në lidhje me shpalljet për punësim, të cilat Komiteti ka marrë vazhdimisht i monitoron, edhe përkundër të gjitha reagimeve të mëparshme, është e qartë se praktika e vendosjes së kushteve diskriminuese për punësim, në njoftimet për punësim, ende vazhdon. Përmes monitorimit në njoftimet për punësim është vërejtur se një pjesë e madhe kërkojnë gra ose burra për një punë caktuar, ose kërkojnë që personat të jenë në një moshë të caktuar, ose vendosni kushte si për gjininë ashtu edhe për moshën. Gjatë vitit Komiteti kishte një çështje për të cilën ishte ngritur ankesë në Komisionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe për cilën Komisioni miratoi një mendim pozitiv i cili përcaktoi diskriminim direkt të shumëfishtë, përkatësisht diskriminim ndaj më shumë se një baze. Pavarësisht mendimeve të tilla nga Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, shpalljet me kushte diskriminuese për punësim ende shfaqen në faqet e internetit për punësim. Nevojitet edukim i shtuar për punëdhënësit dhe

ndërmjetësuesit për punësim në pjesën e kushteve të lejuara për punësim që nuk do të e kufizojnë qasjen për punësimi për çfarëdo arsye. Në periudhën e ardhshme Komiteti vazhdimisht do të aludojë për këtë.

## ■ Diskriminim në sigurimin shëndetësor

Edhe këtë vit, Komiteti shënoi raste të diskriminimit në qasjen të shërbiemeve shëndetësore, por edhe në trajtimin që qytetarët e (nuk) marrin. Në një nga rastet e diskriminimit bëhet fjalë për person me aftësi të kufizuara i cili është i mbrojtur në IP Enti Special - Demir Kapija, i operuar nga kanceri, të cilit duhet të i përcaktohet terapi post operative për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tij. Personi i mbrojtur për herë të parë u dërgua në Klinikë të Onkologjisë në tetor nga dy infermiere të punësuar në entin Special - Demir Kapija. Gjatë vizitës mjekja nuk i pranoi infermieret me të mbrojturin, por vetëm ka kërkuar ti shohë dokumentet që mbanin me vete. I Mbrojturi nuk ishte pranuar as në zyrën e mjekes, e cila ka refuzuar për ta ekzaminuar atë ose për t'i dhënë trajtim të çfarëdo qoftë, duke theksuar se ai ka ku të mjekohet. Në raportin që mjekja ia dha infermiereve shkruan se te pacienti i pranishëm është retardim i rëndë mental, nuk është i kontaktueshëm dhe nuk flet, dhe për shkak të sëmundjeve të tilla dhe shëndetit të përgjithshëm të pacientit, trajtimi i mëtejshëm është i kundër indikuar.

Pas dy muajsh, prindërit vendosën të shkojnë te mjeku vetëm, me gjithë dokumentacionin me qëllim që të kërkojnë djali i tyre të pranohet për ekzaminim dhe të i përshkruhet ndonjë terapi eventuale për shkak të përkeqësimit të dukshëm të gjendjes së tij, Gjegjësisht humbja e vazhdueshme e peshës të trupit. Mjekja së pari nuk donte t'i pranonte, por përsëri i lejoi të hynin në bisedë, në të cilën ajo përsëri ju tregoi se djali i tyre kishte një vend ku të trajtohet, dhe se nuk kanë çfarë të kërkojnë tek ajo. Ajo u tha atyre "të mos i ja sjellin këtu" dhe të mos vijnë më. Prindërit kanë ikur dhe menjëherë rastin e kanë paraqitur te KHM. Për nevojat e prindërve ekipi juridik i KHM mbajti një takim me drejtorin e Klinikës të Onkologjisë, në të cilin takim e njofton drejtorin për sjelljen diskrim-

inuese të mjekes, dhe kërkuan që djali të tyre urgjentisht të i sigurohet mbrojtja e nevojshme e shëndetit. Pas takimit të mbajtur Ai u shqyrtua nga një mjek tjetër nga Klinika e Onkologjisë, dhe i ishte përshkruar terapia e nevojshme, ekipi juridik i Komitetit përgatiti kallëzim penal kundër mjekes që e diskriminoi atë dhe refuzoi t'i japë atij mbrojtje shëndetësore.

## ■ Diskriminimi në qasjen në mallra dhe shërbime

Në vitin e kaluar, Komiteti i Helsinkit ishte përqendruar në procesin e deinstitutionalizimit të fëmijëve dhe personave me paaftësi në zhvillimin intelektual dhe fizik deri në 26 vjet. Duke pasur parasysh faktin, se ky proces përsëri u hap nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Komiteti i Helsinkit mori pjesë aktive, në grupin e punës, të formuar nga ana e Ministrisë për të përgatitur një strategji të re për deinstitutionalizim. Përveç kësaj, Komiteti i Helsinkit i vizitoi institucionet speciale për mbrojtje sociale të personave me aftësi të kufizuara në zhvillimin intelektual ose fizik deri në 26 vjet, nga të cilat përsëri u vërtetua se që IP Enti special - Demir Kapija, gjendet në gjendjen më të keqe dhe se është e nevojshme që të merren masa të menjëhershme për të mbrojtur integritetin moral dhe fizik i të mbrojturve të këtij Enti.

## ■ IP Enti Special - Demir Kapija

Gjatë vitit 2017, përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit vizituan Institucionin Special - Demir Kapija. Vizita u drejtua nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale dhe morën pjesë përfaqësues të UNICEF, UNDP, Delegacionit të BE dhe Koordinatorit të KB në vend. Qëllimi i kësaj vizite ishte përcaktimi i situatës në zyrë nga aspekti i respektimit të të drejtave themelore të njeriut të të mbrojturve, trajtimi i të mbrojturve, si dhe përcaktimi i kushteve në të cilat jetojnë të mbrojturit.

Sipas Strategjisë Kombëtare për deinstitutionalizim 2008-2018, përmes procesit të deinstitutionalizimit, strategjia synon të rrisë cilësinë e kujdesit për kategori të caktuara të qytetarëve në rrezik shoqëror, të cilët identifikohen si grupe të synuara. Një nga qëllimet e vizitës në Demir Kapija ishte të rishikonte se cilat nga masat dhe aktivitetet e propozuara të Strategjisë janë ndërmarrë dhe zbatuar nga Zyra Speciale - Demir Kapija dhe si rezultat, cilat nga problemet e identifikuara më parë janë tejkaluar.

Gjatë vizitës të kryer, evident ishte mosrespektimi i rekomandimeve të dhëna nga Komiteti Evropian kundër Torturës, trajtimin johuman dhe degradues, dhe ndëshkimet në vitin 2014 në raportin e Komitetit. Rekomandimet nga Komiteti, si dhe nga Avokati i popullit dhe Komiteti i Helsinkit nga vizitat e mëparshme të Entit, ishin në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës, trajtimin të të mbrojturve, akomodimit, kujdesi i personelit, mbrojtja shëndetësor. Shqetësues është fakti që rekomandimet e dhëna nuk janë respektuar, dhe se, nga ana e menaxhmentit të Entit, pothuajse asgjë nuk është bërë për të përmirësuar kushtet në Ent. Enti edhe më tutje nuk punëson një mjek të përgjithshëm, dentist dhe gjinekolog. Infrastruktura e brendshme dhe e jashtme e Entit, akoma është në gjendje shumë të keqe dhe dëmtimet ende nuk rregullohen. Muret e jashtme dhe të brendshme dekompozohen, dhe lagështia shkakton myk kudo, e cila është e rrezikshme për shëndetin e të mbrojturve. Numri i profesionistëve, kujdestarëve dhe defektologëve akoma është deficitar dhe për atë nuk ndërmerret asgjë. Shëndeti i përgjithshëm i të mbrojturve akomë është në nivel shumë të ulët, ndërsa numri i të

vdekurve akoma mbetet në të njëjtin nivel, me një rënie të lehtë në vitin aktual. Komiteti është i shqetësuar për gjendjen e të mbrojturve dhe për shëndetin e tyre, trajtimin të cilin ata (nuk) e marrin, dhe mos lëvizja nga pika e vdekur në drejtim të implementimit të Strategjisë Kombëtare për deinstitutionalizim 2008-2018 në Entin Special -Demir Kapija.

**- Shfaqje e rasteve të vdekjeve në periudhën midis viteve 2000 dhe 2017**

Viti	Raste të vdekjeve	Viti	Raste të Vdekjeve	Totali
2000	19	2009	8	196
2001	17	2010	13	
2002	13	2011	7	
2003	10	2012	9	
2004	12	2013	9	
2005	11	2014	9	
2006	11	2015	12	
2007	9	2016	11	
2008	9	2017	7	

## Grupet e ndjeshme

### ■ Personat me aftësi të kufizuara

Mbrojtja sociale në formën ekzistuese për kompensime dhe shërbime edhe më tutje këtë kategori të qytetarëve e mbajnë në nivel shumë të ulët të shkallës shumë të shkallës shoqërore. Në vend të të drejtave që lindin për të krijuar një mjedis të mundshëm për këta persona, sistemi i mban ata “të bllokuar” dhe nuk mundëson pro aktivitet të personave me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, sipas pikëpamjeve të veçanta, shteti ndan shumë para për personat me pengesa. Por dedikimi i mjeteve financiare shpesh herë e lajthit qëllimin dhe në vend se të shërbejnë për kyçe më të madhe sociale, ato përfaqësojnë “fluksi” me të cilin plotësohet buxheti i familjes.

Qasja akoma e pranishme medicinale – defektologe për çështjen e aftësisë së kufizuar në politikat ekzistuese kombëtare shëndetësore nuk ofrojnë qasje të sistematizuar dhe të rrumbullakësuar për realizimin e të drejtave të personave me paaftësi fizike. Ligjet që rregullojnë sigurimin shëndetësor dhe kujdesi shëndetësor ende bazohen në shkakun si ka erdh deri te aftësia e kufizuar, dhe jo për nevojat të krijuara prej saj. Mungon identifikimi i hershëm, dhe shpesh herë ndodh që gratë me aftësi të kufizuar hasin me probleme në realizimin e të drejtave të tyre seksuale dhe riprodhuese për shkak të paarritshmërisë në ordinancat gjinekologjike dhe maternitetet. Problem i hidhur për personat me aftësi të kufizuara janë pamundësia e arritjes dhe përballueshmërisë e objekteve shëndetësore. Një nga pyetjet kyçe të kësaj përralle, gjithsesi se është arsimimi. E vendos si e veçantë, e specializuar dhe e segreguar, ajo nuk lejon krijimin qytetarë të kualifikuar me aftësi të kufizuara të përgatitur posaçërisht për tregun e hapur të punës, që, nga ana tjetër, kontribuon në krijimin e mentaliteti të “invaliditetit-paaftësisë” dhe vetëvlerësimit të ulët të personat me paaftësi. Mes tjerash, në qasjen inkluzive aktualisht të promovuar në arsim është ç’kyçur çështja e aftësisë së kufizuar si pjesë e larmisë së racës njerëzore dhe edukimi i më të rinjve për personat me aftësi të kufizuara. Në atë linjë ndërlihet edhe problemi i

mos ekzistencës së ofruesve adekuat të shërbimeve. Defektologët, ofrues të shërbimeve vetëm në një segment, janë të nevojshëm në jetën e personave me aftësi të kufizuara dhe jo për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht jo për të gjithë personat me paaftësi fizike (fizike dhe shqisore). Nevoja për krijim të shërbimeve të reja dhe krijimi i profileve të reja është segment i domosdoshëm në realizimin e jetës së pavarur të personave me paaftësi.

Sistemi i punësimit ende po përballet me një qasje të veçantë mbrojtëse, pa mundësi më të mëdha për përfshirje të personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në kompanitë e mbrojtura akoma shihet si një zgjidhje ideale e jo si një zgjedhje kalimtare, gjegjësisht si pjesë e rehabilitimit profesional për personat me paaftësi. Edhe më tutje vlen praktika ekzistuese diskriminuese për të vlerësuar aftësinë e personit me aftësi të kufizuara për funksionet udhëheqëse. Është e dukshme mungesa e vetëdijes tek punëdhënësit për aftësimin adekuat, si një mundësi e cila subvencionohet nga ana e shtetit, e cila do të mundësojë që personi i kualifikuar me aftësi të kufizuara në mënyrë aktive të kyçet në procesin e punës.

Ekzistojnë më shumë arsye për cilësinë e kualitetit të dobët të jetës të personave me aftësi të kufizuara. Këta bashkëqytetarë tonë shpesh janë viktima të diskriminimit, e cila jo shpesh është e dyfishtë nëse në kontekst vihet gjinia e tyre, përkatësia etnike, moshë ose ndonjë karakteristikë tjetër kyçe. Shoqëria në tërësi akoma është plot me stereotipa dhe paragjykime për këto qytetarë. Edhe përkundër faktit se shteti filloi qasje për të sjellë ligj për mbrojtjen nga diskriminimi, në të cilën qasja deri te mallrat dhe shërbimet është fushë e diskriminimit, megjithatë, një nga problemet alarmante mbetet paarritshmëria deri te objektet dhe informacionet për qytetarët me aftësi të kufizuara. Evidente është mungesa e të dhënave statistike, e cila në vetvete përfaqëson problem në ridefinimin e politikave publike dhe në hartimin zgjidhje të mira dhe cilësore për qytetarët me aftësi të kufizuara. Këtu, gjithsesi, plotësohet edhe praktika gjyqësore, e cila është e pamjaftueshme për analiza, inicim dhe ndërtim të praktikave të mira.



## ■ Romë

Sfida më e madhe në realizimin e të drejtave të mbrojtjes sociale dhe në përgjithësi të gjitha të drejtat e komunitetit rom është problemi me dokumente për identifikim personal. Sipas informacionit të Ministrisë së punës dhe Politikës Sociale, rreth 700 Romë përballen me këtë problem dhe për arsye nga më të ndryshmet nuk mund të regjistrohen në Regjistrin e Lindjes dhe me këtë janë një nga kategoritë më të rrezikuara dhe derisa nuk kryerjen regjistrim ose nuk zgjidhet statusi i tyre nuk mund të realizojnë asnjë nga të drejtat parapara nga mundësitë ligjore që i ofron shteti. Duke marrë parasysh se shteti nuk disponon me shifra zyrtare për persona pa dokumente (të ashtuquajtur fantazma), Ministria e punës dhe politikës sociale në koordinimi me Drejtorinë për udhëheqje të librave të amzës mori iniciativë për thirrje publike me të cilën u bënë thirrje të gjithë personave që nuk janë regjistruar në librin e amzës të Lindjeve të paraqesin kërkesat në Drejtori për regjistrim shtesë, me çka Maqedonia do të disponoj me shifra zyrtare dhe në të njëjtën kohë do të ketë një pasqyrë për çfarë lloj lëndësh bëhet fjalë. Plotësisht është dorëzuar informacion deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për iniciativën për ndryshim dhe plotësim të ligjit për Procedurën Juridike jashtë gjykatës (që do të prezantohet) mundësia që gjykata të marrë vendim për regjistrimin në librin e amzës me qëllim që të sigurohet identiteti).

Qendrat e Informacionit Rom luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit për të drejta dhe shërbime e bashkësisë të romëve. Në momentin funksionojnë 12 qendra informative rome në 12 komuna dhe janë angazhuar 16 persona (që punojnë në QIR Suto Orizari, Topaana, Tetovë, Gostivar, Manastir, Prilep, Stip, Koçan, Dellçevë, Vinicë, Berovë dhe Kumanovë). Qendrat informative rome punojnë për informim në kohë të përshtatshme, këshillim, udhëzim dhe dhënie mbështetjes logjistike qytetarëve në drejtim që të realizojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre (nga fushat e mbrojtjes sociale, punësimit, shëndetësisë, strehimi dhe arsimit, marrja e dokumenteve personale, etj.). Duke pasur parasysh rolin e tyre, duhet të bëhet transformimi i vendeve të punëve të tyre në marrëdhënie pune me kohë të plotë. Në të njëjtën kohë, i nevojshëm është përforcimi i kapaciteteve të QIR-me në fushën e monitorimit, evaluimit dhe raportimit.

Kur bëhet fjalë për përfshirjen e romëve, progresi në fushën e arsimit e ka tejkaluar përparimin në fushat tjera. Në të njëjtën kohë ekzistojnë sfida në të gjitha nivelet:

- Në nivelin e arsimit parashkollor, Edhe përkrah përparimit domethënës si rezultat i një projekti të implementuar nga ana e pushteteve komunale në bashkëpunim me MPPS dhe i mbështetur nga ana e Fondit të Arsimit Rom, nivelet e regjistrimit të romët ata mbeten më të vegjël më shumë se gjashtë herë se sa mesatarja kombëtare.
- Në arsimin fillor, ekziston një prishje e konsiderueshme të romët, për shkak të një kombinimi të varfërisë, diskriminimit, dhe në disa komuna edhe martesat nën moshë.
- Regjistrimi joadekuat i romëve në edukimin special për fëmijë me aftësi të kufizuara në zhvillimin mendor akoma është problem, veçanërisht në Shkup.
- Strategjia në shkollat fillore si dukuri në Manastir dhe në Prilep.

## Punëtoret e tekstilit

Në vitin 2017, vazhdoi praktika shumë-vjeçare e shkeljes e të drejtave të punës të punëtorëve në industrinë e tekstilit, lëkurës dhe këpucëtarisë nga ana e punëdhënësve. Të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të statistikës tregojnë se 81% e të punësuarve në industritë e përmendura janë gra<sup>15</sup> dhe se ato janë ndër punëtoret më të paguara me pagë mesatare 35% më të ulët se paga mesatare në nivelin shtetëror.<sup>16</sup>

Me ndryshimin e kontekstit shoqëror dhe ndryshimi i pushtetit ishte paralajmëruar ndryshim i politikave dhe praktikave në drejtim të përmirësimit të drejtave të punëtorëve dhe rritja e pagës minimale dhe mesatare. Një nga premtimet parazgjedhore në të cilat bazohej platforma e pushtetit momental ishte rritja e sasisë nominale të rrogës minimale. Në atë drejtim, në vitin 2017, u votuan ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për pagën minimale. Zhgënjyese është ajo se këto ndryshime u bënë në frymën e praktikës ekzistuese paraprake e sjelljes të vendimeve ligjore me procedurë të shkurtuar dhe pa u konsultuar me të gjitha palët relevante të interesuara, përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile. Edhe pse me ndryshimet dhe plotësimet u rrit sasia nominale e pagës minimale, megjithatë, problemi më i madh dhe dispozita kufizuese nga ligji i vjetër për pagën minimale – performanca e standardizuar-plotësimi i normës, mbeti në fuqi. Punëtoret e tekstilit, lëkurës dhe këpucëtarisë janë më shumë prekura nga kjo dispozitë sepse paga e tyre mujore varet nga fakti nëse, dhe sa kanë plotësuar normën- performancën e standardizuar. Ndryshime dhe shtesa të parëndësishme në këtë pjesë parashikojnë se punëdhënësi në të ardhmen do të përcaktoj plotësimin e normës- performancën e standardizuar në konsultim dhe bashkëpunim me punëtorët. Megjithatë, ligji i këtillë ende lë hapësirë për keqpërdorim nga ana e punëdhënësve, me qëllim për ta shmangur detyrimin për të paguar pagën minimale, përcaktojë plotësim normash-peformancash të standardizuara joreale, të larta dhe të paarritshme. Kjo rezulton me mos përbushjen e normave-peformancave të tilla nga ana e punëtorëve

<sup>15</sup> <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.05.pdf>

<sup>16</sup> <http://www.stat.gov.mk/pdf/2018/4.1.18.07.pdf>

dhe punëdhënësve ju lë mundësi ligjore të paguajnë paga në shumë më të ulët se paga minimale e përcaktuar me ligj. Në këtë kuptim, ligji nuk është i qartë dhe i saktë as në aspektin e procedurës dhe bashkëpunimit të punëdhënësit dhe punëtorëve në procesin e përcaktimit të kriterëve të efikasitetit. Ligji nuk specifikon se kush duhet të negociojë në emër të punëtorëve për përcaktimin e kriterëve të efikasitetit me punëdhënësin, si do të zgjidhet përfaqësuesi i punëtorëve, çfarë do të jetë roli i sindikatës në këtë proces.

Gjatë vitit 2017, 308 punëtore të tekstilit, lëkurës dhe këpucëtarisë kanë paraqitur se kishin marrë rrogë më të ulët se me ligj e përcaktuar rroga minimale për arsye se nuk kanë arritur t'i plotësojnë normat-performanca e standardizuar, të përcaktuara nga punëdhënësit.

Përveç problemit me pagimin e pagës minimale, edhe një problem tjetër i shpeshtë dhe i hidhur është pagesa e pagës për pushim vjetor nga punëdhënësit. Duke përdorur paqartësinë e Marrëveshjes së përgjithshme kolektive për sektorin privat në lidhje me plotësimin e kushteve për shfrytëzimin e rekursit për pushim vjetor dhe interpretimi i tij arbitrar dhe i pabarabartë nga e Inspektoratit shtetëror të Punës, një numër i madh i punëtorëve që përdorën pushimin e lehonisë gjatë vitit 2017 nuk mundën të e realizojnë të drejtën e rekursit për pushimin vjetor. Shfrytëzimi i pushimit të lehonisë gjatë vitit kalendarik, një pjesë nga inspektorët e konsiderojnë për mosplotësim të kushtit që punëtorja të ketë punuar së paku 6 muaj në vitin kalendarik të njëjti punëdhënës.

Duke pasur parasysh shkeljet dhe praktikën e treguara, Komiteti i Helsinkit për nevojat punëtoreve të tekstilit, lëkurës dhe këpucëtarisë siguronte ndihmë juridike falas përmes një bashkëpunëtoreje lokale në Shtip dhe shërbimit për ndihmë juridike falas në Shkup. Në vitin 2017 ishin dokumentuar 715 raste të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve 2466 punëtorëve tekstile, të lëkurës dhe këpucëtarisë nga 72 fabrika dhe konfeksione në vend. Shkeljet kishin të bëjnë me: paga të papaguara ose paga të paguara në sasi më të ulët se paga minimale e parashikuar me ligj, shtesa të papaguara mbi pagat, të pa paguar punën jashtë orarit të punës, punë jashtë orarit mbi maksimumin e lejuar ligjërisht, shkelje të së drejtës për të shfrytëzuar pushimin vjetor dhe javor, përfundimi i paligjshëm i marrëdhënies së punës, mobingu, punë në kushte joadekuat

shëndetësore, sanitare dhe të pasigurisë. Ndihma juridike pas rasteve të dokumentuara përbëheshte nga këshilla juridike, informimi i punëtorëve për të drejtat e tyre punëtorë, takime ndërmjetësimi me punëdhënësit, inicim të procedurave administrative dhe përfaqësimi gjyqësor.

Komiteti i Helsinkit inicioi 29 procedura administrative për mbikëqyrje inspektimi të jashtëzakonshme para Inspektoratit shtetëror të Punës dhe Inspektorati sanitar dhe shëndetësor Shtetëror. Edhe pse në 15 nga 29 procedurat e iniciuara, ishin vërtetuar shkelje e të drejtave të punëtorëve, përshtypja e përgjithshme është se mbikëqyrja inspektuese është një mekanizëm joefikas për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Procedurat zgjasin shumë, shpesh nuk e vërejnë gjendjen faktike të punëdhënësit, por edhe në situatat ku vërtetohen parregullsi dhe mangësi të punëdhënësi, sanksioni i vetëm është shqiptimi i gjobës, të cilën punëdhënësi nuk e ka problem të e paguaj dhe edhe më tej të vazhdoj të shkelë të drejtat punëtorë të punonjësve. Punëtorët përmes procedurave administrative, të cilat janë falas dhe në dispozicion të lehtë, nuk mundën të i zgjedhin kërkimet financiare nga punëdhënësit e tyre. Nga ana tjetër, për shkak të të ardhurave relativisht të ulëta dhe rrezikut social në të cilin shoqëror ndodhen, punëtorët e tekstilit, të lëkurës dhe këpucëtarisë kanë qasje të kufizuar deri në drejtësi në drejtim të mbrojtjes gjyqësore. Harxhimet e larta administrative dhe tarifatat e avokatit i pengojnë punëtorët të iniciojnë procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre të punës. Nga këto arsye Komiteti i Helsinkit mbështeti inicimin e dy procedurave gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të punës të punëtorëve të tekstilit. Në rastin e parë bëhet fjalë për paga të papaguara të 105 punëtorëve nga Kriva Pallanka, dhe në rastin e dytë bëhet fjalë për përfundimin e paligjshëm të marrëdhënies të punës. Këto raste u zgjodhën si strategjike sepse ato më së miri pasqyrojnë problemet më të hidhura me të cilat përballen punëtorët e tekstilit, lëkurës dhe këpucëtarisë.

## Rasti strategjik: Pagat e papaguara dhe kontributet e 105 punëtorëve të tekstilit

Në mars, Komiteti i Helsinkit mori informacion se punonjësit në Kompaninë për prodhimin e këpucëve dhe tregtimin KADORO OTTO DOOEL eksport-import Kriva Palanka, nuk kanë marrë paga dhe nuk ju janë paguar kontributet e pagave për janar të vitit 2017. Për atë qëllim ishte për gatit kërkesë për inspektim mbikëqyrës të jashtëzakonshëm e cila ishte dorëzuar në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe në të cilën u kërkuar nga inspektorati për të dalë në terren, për të kontrolluar situatën te fabrika e emëruar dhe të veprojnë brenda kornizës të autorizimeve ligjore. Bazuar në këtë kërkesë, u krye inspektim mbikëqyrës i jashtëzakonshëm nga Inspektorati Shtetëror për punë-NR Kriva Pallanka, meqë u konstatua se punëdhënësi, për muajin janar të vitit 2017 të punësuarve nuk ju ka paguar pagën dhe kontributet ligjore për të. Bazuar mbi gjendjen e vërtetuar faktike nga inspektimi i kryer mbikëqyrës, inspektori kompetent lëshoi një urdher për punëdhënësin dhe personi përgjegjës që ta eliminojnë defektin, gjegjësisht punëtorëve të ju paguhet paga dhe kontributet ligjore për të, për janar të 2017, brenda 8 ditëve nga ekzekutimi i inspektimit mbikëqyrës. Sepse i njëjti punëdhënës nga Kriva Palanka punëtorëve të vet nuk ja u pagoi as Pagën e ardhshme të shkurtit, punëtorët filluan grevë. Në grevë gjithashtu morën pjesë edhe përfaqësues të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut . Për shkak se punëdhënësi nuk veprroi sipas urdhrit nga Inspektorati Shtetëror i Punës, dhe brenda afatit të dhënë punëtorëve të vet nuk ja u pagoi rogen e prapambetur, Komiteti i Helsinkit dërgoi kërkesë për vazhdimin e procedurës pas kryerjes të inspektimit mbikëqyrës, në të cilin kërkoi nga inspektorati shtetëror i punës të veprojë në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe të paraqesë një kërkesë për fillimin e një procedure për kundërvajtje. Në përgjigjen të kërkesës kështu të paraqitur, inspektorati shtetëror i punës na informoi se nuk kishte gjetur asnjë veprim nga punëdhënësi sipas urdhrit të lëshuar, dhe se ka shqiptuar gjobë për kundërvajtjen. Punëdhënësi menjëherë në ditën ardhshme ka bërë pagesën e gjobës së vlerësuar në shumën e plotë prej urdhrit të pagesës të lëshuar për kundërvajtje. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për shkelje e të të drejtave të punëtorëve

për përafërsisht 100 punëtorë dhe punëtorë, dhe mos pagesa, dhe pagesa e vonuar e pagave dhe kontributeve të pagave është problem me të cilin përballen pothuajse të gjithë punëtorët dhe punëtorët e tekstilit, Komiteti i Helsinkit e zgjodhi këtë çështje si një rast strategjik dhe vendosi për të, të inicioj procedurë gjyqësore. Pasi u ngrit një proces gjyqësor për pagat e papaguara dhe kontributet e pagave. Gjykatë Themelore në Kriva Palankë në vitin 2017 solli vendim me të cilin e pranoi kërkesën pandeheshe e 105 punëtorëve dhe punëtorëve të tekstilit nga DPÇT KADORO OTTO DOOEL eksport-import Kriva Pallanka. Gjykata urdhëroi të pandehurin punëdhënës, që punëtorëve dhe punëtorëve të u paguante shumë totale prej 1,430,856.00 denarë, për paga të papaguara për shkurt të vitit 2017, kontribute për sigurim të detyrueshëm social për shkurt të vitit 2017, kontribute për SPI në Fondin për sigurimin pensional invalidor e RM-së, kontribute për sigurim shëndetësor, kontribute për punësim dhe tatim personal në Drejtorinë për të ardhurat publike, me kamatë ligjore ndëshkuese për pagën e papaguar. Kundër aktgjykimit të tillë të Gjykatës Themelore në Kriva Pallankë i pandehuri paraqiti një ankesë në Gjykatën e Apelit në Shkup. Gjykata e Apelit solli aktgjykim me të cilin e hodhi ankesën e të pandehuri dhe e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

# MIGRANTË, REFUGJATË DHE AZIL KËRKUES

Kriza globale e refugjatëve, e cila filloi në vitin 2014, veçanërisht i tronditi vendet evropiane dhe ballkanike, të cilat në mënyrë të pashmangshme u gjetën në rrugën e mijëra refugjatëve. Në mesin e atyre vendeve u gjend edhe Republika e Maqedonisë, e cila për gjatë tre vitet e mëparshme ka qenë vazhdimisht e drejtuar para testit për respektimin pa pengesa dhe mbrojtjen e duhur e të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit që janë gjendur në territorin e saj. Duke u përballur me fluksin e paparë të refugjatëve, Maqedonia kurrë nuk u bë një vend destinacioni për ta, por përkundrazi, mbeti vend i transitit, që shihet qartë nëse krahasojmë numrin e refugjatëve që kaluan nëpër Republikën e Maqedonisë dhe numrin e personave që zyrtarisht kanë aplikuar për azil. Sipas të dhënave statistikore nga Komisariati i Lartë për refugjatët (UNHCR), gjatë vitit 2017 nëpër Republikën e Maqedonisë janë regjistruar 17,000 refugjatë / migrantë. Duke pasur parasysh, numri e refugjatëve që kaluan nëpër vend, zbatimit të politikave dhe praktikave të ndryshme dhe shkeljeve të regjistruara të të drejtave të njeriut, krahasuar me vitin 2016, dinamika e krizës refugjate ishte e zvogëluar, por në asnjë rast nuk mundet të quhet e mbaruar. Pavarësisht nga kufijtë e mbyllur e një pjese më të madhe të vendeve evropiane, refugjatë dhe migrantë vazhdua të lëvizur nëpër rrugë të parregullta, të lënë vetëm në veten e tyre dhe grupet e kontrabandës, pavarësisht nga rreziku i jetës së tyre ose siguria.

Për dallim nga vitet e kaluara, gjatë vitit 2017 Republika e Maqedonisë arriti që refugjatëve të u sigurojë kushte më të mira jetese për qëndrim në qendrat pranuese dhe transit, por nuk arritën të përmbahen nga praktikimi i paligjshëm i "Deportimit" të refugjatëve përtej kufirit jugor, që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë të standardeve ndërkom-bëtare për të drejtat e njeriut. Përveç kësaj praktike, në raste të izoluara janë vërtetuar edhe shkelje të të drejtave të tjera, siç është e drejta për liri dhe siguri, ndalimi absolut i torturës, trajtim johuman dhe degradues, qasjen deri te ilaçi efektiv juridik dhe në një rast edhe e drejta për jetë. Duke u përballur me krizën më të thellë politike dhe ndryshimi i pushtetit, Republika e Maqedonisë nuk i ndryshoj qëndrimin dhe mënyrën e



trajtimit të krizës refugjate. Tërësisht e kundërta, çështja e refugjatëve ishte keqpërdorur për qëllime politike dhe strukturave të caktuar politike ju shërbeu si instrument për nxitjen e urrejtjes dhe jo tolerancës, duke u përpjekur të shpërqendrojë vëmendjen e opinionit nga kriza politike.

Me praninë e saj aktive në kampet e pritjes-transitit, Komiteti i Helsinkit u përqendrua në identifikimin e lëndimeve të të drejtave themelore të njeriut dhe liritë e refugjatëve dhe migrantëve dhe raportimi i tyre te opinioni vendas dhe ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, ai ndërmori aktivitete të shumta që synonin ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjen e refugjatëve dhe u përpoq të ndikojë në sjelljen dhe zbatimin e politikave shtetërore dhe të institucioneve kompetente për rritjen e respektimit të të drejtave të refugjatëve dhe migrantëve. Gjatë vitit 2017, me vendim të Kuvendit të Republikës së Maqedonia, në dy raste /17<sup>17</sup> ishte zgjatur gjendja e krizës në dy linjat kufitare, gjegjësisht në kufirin jugor me Greqinë dhe në kufirin verior me Serbinë. Me këtë, rolin kryesor në koordinim me institucionet kompetente akoma e kishte Qendra e Menaxhimit me Kriza.

## Kampet e pritjes-transitit

Kampet e themeluara pritje-transit (PTC)<sup>18</sup> në Vinojug, Gjevgjelia dhe në Tabanocë, Kumanovë, vazhduan të funksionojnë në të njëjtën mënyrë gjatë vitit 2017, me përmirësime të vogla në infrastrukturë të drejtuar kah sigurimi i kushteve të mira të jetesës. Qendra e Menaxhimit të Krizave vazhdoi të koordinojë me kampet, ndërsa nga institucionet kompetente të pranishëm akoma janë Ministria e Brendshme, Ministria e Punës dhe politikës sociale dhe Ministria e Shëndetësisë me përfaqësuesit e tyre. Përveç institucioneve shtetërore, kontribute domethënës në funksionimin e kampeve transite realizuan edhe organizatat e shoqërisë civile (ndërkombëtare dhe kombëtare), në mesin e të cilëve të pranishëm

17 Vendimi I pare është sjellë në qershor të vitit 2017, ndërsa e dyta në dhjetor të vitit 2017, me çka gjendja e krizës u vazhdua deri në fund të qershorit të vitit 2018.

18 Që nga formimi e deri në mesin e vitit 2016 kampet ishin emërtuar si qendra transite, ndërsa që nga mesi I vitit 2016 ishin riemërtuar në qendra pritje-transit, që e pasqyron përdorshmërinë e tyre.

janë: Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Shërbimi Jezuit i Refugjatëve (JRS), Këshilli Danez i Refugjatëve (DRC) dhe OSBE me prezencë të herëpashershme në kampe. Nga kombëtares OSHC-të janë të pranishme janë: Shoqata Maqedonase e juristëve të rinj, Legis, Open Gate (La Strada) dhe të kryqi i kuq. Secila prej këtyre organizatave siguronte mallra dhe shërbime për refugjatët dhe migrantët brenda mandatit dhe zonës së tyre të veprimit.

Dallimi kryesor në funksionimin e kampeve është në transparencën e tyre. Kështu, për shembull, PTC Vinojug në Gjevgjeli është një kamp i karakterit të mbyllur, pra refugjatët dhe migrantët të cilët qëndrojnë atje nuk kanë mundësi të lëvizin lirshëm jashtë kampit. Gjatë vitit 2017 kjo politikë e të qenit mbyllur u ndryshua pjesërisht, duke u dhënë mundësi që refugjatët të bëjnë shëtitje në qytet sipas nevojës, me njoftim paraprak dhe të shoqëruar nga përfaqësuesit e institucioneve ose të Kryqit të Kuq. Ndryshe nga ajo, PTC Tabanocë, Kumanovë, është një kamp i karakterit të hapur në të cilin refugjatët e strehuar e kanë mundësinë që të pashoqëruar dhe pa ndalim të dalin dhe të kthehen në kamp. Një nga problemet më të rëndësishme që ishin regjistruar në PTC Tabanocë ishte pranimi selektiv i refugjatëve dhe migrantëve që do të paraqiten te kampi, si dhe mos regjistrimi i refugjatëve të caktuar që ishin vendosur në kamp. Për praktika të tilla, të cilat vërehen gjatë gjithë vitit, nuk ekzistojnë rregulla ose kritere të caktuara, por zbatohen sipas vullnetit individual të punonjësve të policisë që janë në nderim pune.

Në fillim të vitit, në PTC Vinojug ishin vendosur rreth 90 refugjatë me origjinë të ndryshme dhe shumica e tyre në kamp qëndruan më shumë se 10 muaj. Numri gradualisht filloi të ulet në tre muajt e parë të vitit, kur individë ose familjet e vendosur në kamp kërkuan të ktheheshin në Greqi. Arsyet për këtë, sipas tyre, janë ndjenja e të qenit të bllokuar në kamp dhe ngërçi i situatës së tyre. Gjatë muajit mars të vitit 2017 numri u ul në 8 refugjatë dhe deri në fund të vitit, me ardhjen dhe largimin e vazhdueshëm të refugjatëve, numri asnjëherë nuk kaloi mbi 20 refugjatë që qëndronin brenda kampi. Në të kundërtën, numri i refugjatëve të vendosur në PTC Tabanocë ndryshonte vazhdimisht. Në fillim të vitit numri ishte rreth 100 dhe gjatë muajve në vijim numri dukshëm u zvogëluar në rreth 20 refugjatë. Në periudhën vijuese, si rezultat i mbërritjes së shpeshtë të

grupeve të reja, numri përsëri u ngjit në 90, por në muajt e fundit të viti nuk i kaloi 20 refugjatë.

Për të gjithë refugjatët që arrijnë në kampe, pavarësisht nëse kanë ardhur vetë ose i ka sjellë policia, atyre urgjentisht u sigurohet ndihma primare mjekësore dhe humanitare, gjegjësisht ushqim, ujë dhe veshje të përshtatshme. Personave që shprehën dëshirë të jenë vendosur dhe të qëndrojnë në kampe, menjëherë u ishte siguruar hapësirë (kontejner) e akomodimit. Refugjatët të cilët kishin nevojë për kujdes shtesë shëndetësor (ekzaminime specialiste ose ndërhyrje shtesë) menjëherë me urgjencë u dërguan në spitalin më të afërt lokal. Për gratë që në periudha të ndryshme ishin të pranishme në kampe rregullisht ishin siguruar kontrole gjinekologjike ndërsa për fëmijët në dispozicion ishte një pediatër. Mirëmbajtja e higjienës në kampe dinte të ishte një sfidë për shërbimet kompetente. Deri në prill të vitin 2017, higjiena ishte në një nivel të palakmueshëm. Duke filluar nga Prill, mirëmbajtja e higjienës iu la IOM-it, me çka e cila ndjeshëm u përmirësua.<sup>19</sup> Probleme dhe ankesa e herëpashershme nga refugjatët ishin vërejtur në aspektin e cilësisë të ushqimit që merrnin. Kur numri i refugjatëve ishte më i lartë, ata kishin mundësinë vetë të përgatisnin ushqimin e tyre në kuzhinat të cilat u ishin vënë në dispozicion, por në periudhat kur numri i refugjatëve ishte më të vogël, ju shërbenin vetëm ushqim të konservuar. Në një kohë kur numri i refugjatëve ishte më i lartë, për fëmijët rregullisht mbaheshin programe edukative, gjithashtu organizoheshin edhe programe rekreative për fëmijët dhe gratë nga ana e organizatave të shoqërisë civile. Kur numri i refugjatëve u zvogëlua, praktikisht ishte e pamundur të mbahen programet arsimimore për shkak të periudhës së shkurtër të qëndrimit të refugjatëve.

19 Në periudhën e mëparshme higjienistët angazhoheshin përmes Ministrisë të punës dhe politikës sociale, dhe kampet ballafaqoheshin me probleme rreth mirëmbajtjes të higjienës

## Migrimi dhe deportimi i parregullt

Për shkak të kufijve të mbyllur, gjatë vitit 2017 Republika e Maqedonisë është përballur me rritje të migrimit të paligjshëm. Pothuajse çdo ditë grupe më të vogla ose më të mëdha janë hasur nga policia në rrugë të parregullta në të gjithë vendin. Lëvizje të tilla gjatë vitit janë vërejtur në dy drejtime: së pari, refugjatët që vetëm ose me ndihmën e një kontrabandisti nga Greqia kalojnë në Maqedoni në mënyrë që të arrijnë në Serbin. Në grupet e tilla janë vërejtur edhe njerëz që kishin më shumë se 5 përpjekje për të kaluar këtë rrugë. Kur udhëtojnë me ndihmën e kontrabandistëve, shpesh paguajnë një shumë të madhe parash (nga 2000 deri në 5000 euro për person), dhe shpesh ndodh të mashtrohen nga ana e kontrabandistëve dhe në vend që të shkonin në destinacionin e dakorduar, i linin ata në n vend të panjohur në Maqedoni. Së dyti, I rritur është numri i refugjatëve të kthyer nga Serbia në Republikën e Maqedonisë, me forcë ose vullnetarisht, dhe dëshira e vetme e të cilit ishte sa më shpejt të jetë e mundur të kthehen në Greqi. Arsyet për këtë më së shpeshti janë të zakonshmet prania e një familje në Greqi, mundësia e fitimit të mjeteve financiare, si dhe lidhje më të lehtë me grupet e kontrabandës nga atje.

Një nga shkeljet kryesore të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është praktika e përditshme e shërbime të sigurisë të "deportimi" të refugjatëve nga Maqedonia në Greqi. Dëbimi bëhet mënyrë jo zyrtarisht, pa bashkëpunim me shërbimet e sigurisë në vendin fqinj, pa shqyrtim individual të secilit rast si dhe pa u lëshuar vendime zyrtare nga shteti për dëbimin, i cili është drejtpërdrejtë në kundërshtim me nenin 4 nga protokollin i katërt i konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Refugjatët transportoheshin me automjete në vijën kufitare dhe thjesht lireshin të kalojnë nëpër të, në fushë e hapur, nën qiellin e hapur. Nga vëzhgimet e Komitetit të Helsinkit dhe në mungesë të statistikave zyrtare nga shërbimet shtetërore, gjatë vitit 2017 janë vërejtur rreth 800 refugjatë dhe migrantë që janë transferuar në territor kah Greqia, dhe midis tyre të pranishëm janë burra, gra dhe fëmijë. Nga vendet të origjinës, më të zakonshmet janë Siria, Afganistani, Pakistani, Iraku, Irani dhe Algjeria, dhe në raste të rralla Palestina, Maroku dhe Libia. Në shumicën


e rasteve, kur refugjatët gjenden nëpër rrugë të parregullta, fillimisht dërgohen në PTC Vinojug, ku regjistrohen dhe identifikohen dhe ku ju sigurohet ndihmë mjekësore dhe humanitare, Pas çka për një periudhë të shkurtër (në varësi të shëndetit dhe stërlodhjes së tyre) janë transferuar kah Greqia. Megjithatë, kjo jo gjithmonë është rast, duke pasur parasysh atë se ekzistojnë njohuri se grupe më të mëdha refugjatësh janë transferuar kah Greqi direkt pas mbajtjes disa orësh në stacion policor.

Rasti i vetëm i ri pranimit ligjor ndodhi gjatë shkurtit të vitit 2017, kur pas komunikimit të hapur dhe bashkëpunimit me shërbimet greke, 50 refugjatë dhe migrantë nga PTC Tabanocë u transportua me autobus për në Greqi, ku ishin të vendosur në qendrat e pritjes dhe kampe. Pavarësisht nga ligjshmëria procedurës, ri pranimi u krye në orët e vona të natën, pa njoftim paraprak të refugjatëve dhe pa praninë e të gjitha organizatave qytetare që vepronin në terren Për shkak të kësaj, procedura u vlerësua si johumane.

## Aksesi në azil

Krahasuar me vitet e mëparshme, në vitin 2017 në Republikën e Maqedonisë ishin dorëzuar pak kërkesa për njohje të drejtën e azilit. Me çka, për dallim nga më parë, nuk ishin vërejtur shkelje më të mëdha për sa i përket realizimit të kësaj të drejte. Çdo person, refugjat ose migrant që shpreh qëllimin për të kërkuar azil, menjëherë i ishte siguruar shpjegim për tërë procedurën dhe mundësinë e paraqitjes së kërkesës. Sektori për azil pranë Ministrisë së Brendshme në disa raste realizoj vizita në dy qendrat transite, ku realizoi bisedë me azilkërkuesit. Pas dorëzimit të kërkesës, personat, në afat sa më e mundur të shpejtë u transferuan në Qendrën e Pritjes për azilkërkuesit në Vizbeg.

Përmbledhje e kërkesave për azil 2015 – 2017



Sipas të dhënave statistikore të marra nga Ministria e punëve të brendshme, gjatë vitit 2017 janë dorëzuar gjithsej 147 kërkesa për njohjen e të drejtës së azilit, për 162 kërkues. Pas procedurës të kryer, vetëm katër personave me origjinë nga Sirisë dhe një personi nga Pakistani u është dhënë mbrojtje subsidiare, dhe asnjë personi nuk i është dhënë statusi i refugjatit i njohur. Edhe pse nuk janë vërejtur shkelje në procedurën për azil, simptomatike është praktika vendimmarrëse e sektorit për azil, dhe vihet në pyetje shqyrtimi efektiv i kërkesave të paraqitura.

## Strategjia kombëtare për integrim refugjatë dhe të huaj

Miratimi i Strategjisë së re Kombëtare për refugjatë dhe të huaj, një nga dokumentet kyçe të Ministrisë së Punës dhe politikës sociale e cila përcakton politikën e shtetit në trajtimi i refugjatëve të njohur, gjatë vitit 2017 ndezi një debat të trazuar publik të mbushur me fjalim ksenofobi dhe grindje politike. Edhe pse Strategjia është kryer me një vonesë prej 2 vitesh,<sup>20</sup> procesi sjelljes filloi mjaft transparente, gjegjësisht. iu dha hapësirë shoqërisë qytetare për të kontribuar me komentet e saj në tekstin e propozuar. Sidoqoftë, në mes të krizës politike në shoqëri, ndryshimi i pushtetit dhe shpalljet e zgjedhjeve lokale për tetor vitit 2017, nga ana e disa strukturave të caktuara politike u hap debat e ashpër publike rreth masave të parashikuara në Strategji. Për çka, në një pjesë të madhe të opinionit u krijua një imazh se Maqedonia do të pranonte mbi 200,000 refugjatë në territorin e saj dhe do të ndajë sasi domethënëse mjete buxhetore për integrimin e tyre, që ishte imazh rrejshëm i krijuar për të e frikësuar popullatën lokale. Në tërë debatin publik ishte përdorur gjuhë e urrejtjes e cila propagandonte se refugjatët janë të rrezikshëm për shtetin, se janë të dhunshëm dhe se do ta rrisin e kriminalitetin në vend. Me këtë u krijua frikë, urrejtje dhe jo tolerance<sup>21</sup> ndaj refugjatëve. Aq më tepër u paraqitën edhe iniciativa qytetare që bënin thirrje për zbatim të referendumeve në nivelin lokal kundër pranimin të refugjatëve në komuna të caktuara. Referendumet të propozuara asnjëherë nuk u zhvilluan, duke marrë parasysh se ishin planifikuar për të njëjtën ditë me zgjedhjet lokale, në çka qartë shiheshete qëllimi për manipulim politik me çështjen refugjate. Pas disa punëtorive të mbajtura me Ministrinë e Punës dhe politikës sociale mbi të cilat u finalizuan teksti dhe koncepti i Strategjisë Kombëtare, deri në fund të vitit ajo ende nuk ishte miratuar.

20 Претходната Национална стратегија за интеграција на бегалци и мигранти беше за периодот 2008-2015

21 Регистрирани се неколку случаи на говор на омраза кон бегалците <http://govornaomraza.mk/reports/view/907>

<http://govornaomraza.mk/reports/view/911>

<http://govornaomraza.mk/reports/view/909>

## Ligj për mbrojtjen ndërkombëtare dhe të përkohshme

Në fund të vitit, Ministria e punëve të Brendshme e publikoi propozim-tekstin e Ligjit të ri për Azilin, tani i riemëruar në Ligji për mbrojtjen ndërkombëtare dhe të përkohshme. Qëllimi kryesor i ligjit të ri ishte harmonizimi me direktivat evropiane për trajtimin e refugjatëve dhe azilkërkuesve të njohur, gjë që do të çoi në rritjen e respektit për të drejtat e tyre.

Ana pozitive e projekt-ligjit është se nuk i përmban ndryshimet e këqija ligjore nga qershori i vitit 2016, me të cilën kufizoheshete me kohë periudha e bashkimit familjar dhe si vend i tretë i sigurt përcaktoheshte secila anëtare e BE, NATO dhe EFTA. Në ligjin e ri ruajt "qëllimi për të kërkuar azil» që u mundësoj refugjatëve dhe migrantëve legalisht të lëvizin në të gjithë vendin, duke përdorur transportin publik, me që pa bërë shkelje.

Përfshirja e plotë e direktivave evropiane ka provokuar disa ndryshime të rëndësishme në ligjin e ri. Së pari, për herë të parë futen orientimi seksual dhe identitetin gjinor si arsye për persekutim dhe mundësia për të kërkuar mbrojtje nga shteti, e që është pozitive. Së dyti, u fut mundësia e kufizimit të lirisë të lëvizjes së azilkërkuesve, që është problematike. Edhe pse parashikim i tillë është në përputhje me Direktivat Evropiane dhe rastet në të cilat mund të kufizojë lirinë e azilkërkuesve, duke e njohur praktikën maqedonase të veprimit dhe rrethanat e krizës refugjate, ekziston një potencial i konsiderueshëm për keqpërdorim nga ana e autoriteteve shtetërore. Për më tepër, duke pasur parasysh se procedura për të kërkuar azil zgjat relativisht më shumë se afatet e parashikuara ligjërisht, i pashmangshëm është mendimi se privimi i lirisë do të zgjaste relativisht gjatë dhe mund të çon në shkelje të të drejtave të azilkërkuesve.

Komiteti i Helsinkit paraqiti komentet e tij te Ministria e punëve të Brendshme, përmes së cilës në kthimin e përgjigjes ishte i informuar se dy nga pesë komentet ishin pranuar, dhe tre u refuzuan. Këto komente që tregojnë për probleme praktike me të cilat përballen azilkërkuesit gjatë implementimit të Ligjit, por për zgjidhjen e kujt do të ishte e nevojshme qasje sistematike dhe ndryshimi i më shumë ligjeve.



## ■ Incidentet e regjistruara dhe shkeljet e të drejtave

Përveç praktikës së përditshme të dëbimit të paligjshëm, i cili është në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Komiteti i Helsinkit në mbikëqyrjen e vet vuri në dukje disa incidente të izoluara në të cilat në mënyrë direkte janë shkelur të drejtat e refugjatëve, me veprime të ndara të nëpunësve shtetëror. Kështu, për shembull, shkelje janë vërejtur në të drejtën e jetës, ndalimi absolut i torturës, veprim jo human dhe çnjerëzor, e drejta për liri dhe siguri. Për të gjithë incidentet e përmendur, Komiteti i Helsinkit u drejtua deri te Ministria e punëve të brendshme, dhe procedurat janë ngritur nga ana e avokati të popullit.

## ■ Kufizim i paarsyetuar i lirisë (Neni 5 KEDNJ)

Gjatë korrikut të vitit 2017 në PTCVinojug, Gjevgjeli, është sjellë një refugjat me origjinë nga Pakistani, i cili menjëherë është strehuar në një kontejner të veçantë, i ndarë nga refugjatët e tjerë në kamp. Pas vëzhgimit disa ditësh u vu re se personit nuk i lejohet të e lëshoj kontejnerin, i cili është i kyçur, ndërsa për të përmbushur nevojat në kamp (ushqim dhe nevojat fiziologjike) lëviz vetëm kur është i shoqëruar nga persona zyrtarë. Sipas informacioneve nga burime të ndryshme, u zbulua se ekzistonte dyshimi se personi i sëmurë me hepatit C, për shkak të të cilës mbahet i izoluar derisa kryhen ekzaminimet mjekësore. Komiteti i Helsinkit me shkrim iu drejtua Ministrisë së punëve të Brendshme dhe e mori përgjigjen se me rekomandimin e personave mjekësor, refugjati mbahet i izoluar. Nuk është e qartë pse u bë një rekomandim i tillë, kur edhe një laik do të dinte për mënyrat e transmetimit të hepatitit C. Pasi Komiteti i Helsinkit informoi Avokati i popullit për situatën e vëzhguar, pas më shumë se 5 ditësh në izolim personi u la i lirë. Pas vetëm disa ditëve u transferua në anën Greke. Një kufizim i tillë i lirisë është në kundërshtim me nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe nenin 12 me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ku

qartë parashihen rastet kur dhe në cilat kushte një personi mundet të i kufizohet liria e lëvizjes.

## Tortura, poshtërimi dhe trajtimi degradues dhe privimi i paarsyeshëm nga liria (Neni 3 dhe neni 5 i GJEDNJ)

Një nga rastet më serioze të thyerjes së ndalesës absolute të torturës dhe privimit të paligjshëm nga liria ishte zhvillimi i aksionit policor në PTC Tabanocë, në të cilin 10 refugjatë që ishin vendosur gjatë ditës së kaluar u arrestuan nga policia në një mënyrë brutale dhe u transferuan kah Greqia. Gjegjësisht, aksioni u krye në orët e hershme të mëngjesit (rreth orës 5 të mëngjesit). Me përdorimin e tepërt të forcës fizike dhe mjetet e detyrimit, policia arrestoi 10 refugjatë, ndërsa të tjerët arritën të ikin. Të vetmit dëshmitarë të ngjarjes ishin refugjatët e vendosur në kamp. Pas paraqitjes te Ministria e punëve të Brendshme për arsyeshmërinë e përdorimit të tepruar të forcës, ishte marrë përgjigje se personat konsideroheshin të rrezikshëm dhe agresivë, prandaj pra ishin përdorur mjetet e detyrimit, ndërsa forca e përdorur ishte proporcionale me situatën, ku ishin “zbuluar dhe kapur 10 refugjatë”. Kjo përgjigje është e paqartë dhe kontradiktore nëse kihet parasysh që refugjatët u sollën dhe u vendosën në kamp një ditë më parë nga oficerët e policisë. Me këtë akt drejtpërdrejt shkelen nenet 3 dhe 5 të KEDNJ-së.

## E drejta për jetë dhe e drejta për liri dhe Siguri (neni 2 dhe neni 5 i GJEDNJ)

Gjatë dhjetorit të vitit 2017 në PTC Tabanocë është regjistruar një incident në të cilin, në kamp për disa kohë ishte i strehuar një refugjat, në gjendje alkoolike ka filluar të tregoj sjellje agresive. Fillimisht ju është kërcënuar të tjerëve, dhe më vonë ka filluar të dëmtojë veten. Me që, nga ana e dy oficerëve e policisë të pranishëm në kamp, asnjëri nuk ka ndërmarrë kurë fare autorizimi policor për të e zotëruar ose parandaluar në veprim, por ajo u bë nga ana e të tjerëve të pranishëm në kamp. Me mos veprimin e policisë, e cila është e obliguar të e mirëmbajë dhe garantojë sigurinë e të gjithë të pranishmëve në kamp, rrezikohet e drejta për jetë dhe e drejta për liri dhe siguri. Ngjarja është raportuar nga koordinatori i kampit (CMC). E drejta për jetë është shkelur edhe në një rast tjetër, ku dy refugjatë janë viktimat të krimit të urrejtjes, njëri prej tyre vdiq për shkak të ashpërsisë së plagëve të tij. Rasti u regjistrua në shkurt të vitit 2017 kur në autostradën Kumanovë - Shkup, janë vërejtur dy persona me lëndime të dukshme. Pas raportimit në polici, ata menjëherë janë transferuar në spitalin lokal ku njëri iu nënshtrua plagëve, ndërsa tjetrit iu konstatuan lëndime të rënda trupore. Ky nuk është rasti i vetëm i një krimit të regjistruar nga urrejtje<sup>22</sup>, gjegjësisht vepër në të cilën refugjatët janë fizikisht të sulmuar dhe grabitur në territorin e Republikës së Maqedonisë. Policia po punon në pastrimin e rastit me vrasje, por rastet e mbetura nuk përpunohen për shkak të refuzimit të refugjatëve të mbeten në territorin e Republikës së Maqedonisë.

22 <http://www.zlostorstvaodomraza.mk/reports/view/407>

## NDIHMJA JURIDIKE FALAS

Komiteti i Helsinkit, si një shoqatë e autorizuar e dhënies ndihmë juridike falas, përmes komunikimit direkt të përditshëm me qytetarët, ju ofron ndihmë juridike në formën e këshillimeve juridike dhe këshillës fillestare dhe mundësisht plotësimin e kërkesave për ndihmë juridike falas në procedurat civile dhe administrative në fushat sociale, shëndetësore, sigurimi pensional-invalidor, marrëdhëniet e punës, mbrojtja e fëmijëve, viktima të dhunës në familje, mbrojtja e viktimave të dhunës në familje, mbrojtja e viktimave të trafikimit me njerëz, njohja e të drejtës së azilit dhe çështjet pronësore-juridike, personave, të cilët i plotësojnë kriteret strikte të parashikuara me Ligjin për ndihmën juridike falas, personave të cilët, duke pas parasysh pozitën e tyre materiale, nuk janë në gjendje ta sigurojnë qasjen në drejtësi dhe mbrojtje gjyqësore.

Në vitin 2017, 313 qytetarë iu drejtuan Komitetit të Helsinkit me kërkesë për ndihmë juridike falas në zona të ndryshme të drejtësisë. Nga kërkesat dominuan lëndët penale, mbrojtja e viktimave të dhunës në familje, çështjet pronësore-juridike, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet e punës, mbrojtjen sociale dhe sigurimi pensional-invalidor dhe rastet e kundërvajtjes. Në vitin 2017 Komiteti i Helsinkit paraqiti gjithsej 13 kërkesa për ndihmë juridike falas në Ministrinë e drejtësisë. Nga të paraqiturat vetëm 6 kërkesa u miratuan, dhe nga të tjerat, 2 u tërhoqën, 2 u refuzuan, dhe 3 ende janë në procedurë.

Ligji për Ndhmën Juridike Falas është sjellë në vitin 2009, i cili filloi të aplikohet nga viti 2010, synonte të sigurojë të akçes barabartë në drejtësi, veçanërisht për grupet e prekshëm dhe të marginalizuar përmes përdorimit të ndihmës juridike falas në lëndët civile dhe administrative. Me gjithë atë, në praktikë ishin vërtetuar mangësi e vetë ligjit dhe sistemit në tërësi për ndihmën juridike falas, e cila rrjedhimisht rezultoi në një të vogël të kërkesave për ndihmë juridike falas kundrejt numrit dukshëm të madh i kërkuësve.

Në këtë drejtim, për ndryshimet e nevojshme në sistemin t; përgjithshëm për ndihmë juridike falas në rrjetin joformal "Hyrja në drejtësi" hartoi një

dokument të politikës publike<sup>23</sup> n; t; cilin në detaje janë të shpjeguara mangësitë e sistemit dhe propozoi zgjidhje përtë përmirësuar mangësitë. Nga numri i madh i mangësive të vërtetuara dhe mosfunksionimi i Ligjit, problemi kryesor është disponueshmëria e pamjaftueshme e ndihmës juridike falas për personat që jetojnë në buzë të ekzistencës, që rezulton me në një numër të vogël i kërkesave të paraqitura dhe të aprovuara për ndihmë juridike falas.

Një problem i rëndësishëm është kohëzgjatja e vendimmarrjes nga ana e Ministrisë të Drejtësisë në korrelacion me organet tjera shtetërore (Qendrat për punë sociale, Agjencia për kadastër i pasurive të patundshme, drejtoria e të ardhurave publike, Agjencia për punësim), të cilët janë të obliguar për mbledhjen e të dhënave për person kërkues e NJF. Gjegjësisht, përkundër faktit se ligjvënësi ka parashikuar urgjencë në vendimmarrje, deri në maksimum 20 ditë, kohëzgjatja aktuale e procedurës është mbi 60 ditë. Me dinamikën të tillë të mosveprimit në procedura të caktuara ku natyra e çështjes juridike është me afat më të shkurtër, drejtpërdrejtë përket mbi të drejtën për mbrojtje gjyqësore dhe qasje në drejtësi. Në lidhje me afatet ligjore për marrjen e vendimeve për kërkesat për ndihmë juridike falas, i nevojshme është gjithashtu harmonizimi i atyre afateve me Ligjin për procedurën gjyqësore dhe Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative. Për më tepër, problematike për funksionalitetin janë gjithashtu interpretimet e ndryshme të dispozitave të Ligji dhe praktika e vendosur nga ana e Ministrisë për drejtësi, e cila kontribuon për pasiguri juridike.

23 RAPORT për aprovimin e ligjit për ndihmë juridike falas në vitin 2016-2017 <http://www.soros.org.mk/CMS/Files/Documents/Monitoring-report-2017-MK.pdf>

## Propozim-drafti i ri i Ligjit për ndihmë Juridike falas

Me propozim-draftin e ri e ligjit për ndihmën falas, botuar kah fundi i vitit 2017, një numër i madh nga rekomandimet dhe propozimet nga ana e shoqatave të qytetarëve që japin ndihmë paraprake juridike ishin të pranura dhe përgjithësisht ka tendencë për përparimin e gjendjes momentale të personave të prekshëm dhe të marginalizuar.

Me rëndësi të madhe është zgjerimi i zonave ligjore që tani janë të përmblodhura në Ligj, domethënë, propozim-ligji i ri është i zgjeruar në të gjitha fushat e çështjeve civile dhe atyre administrative, me përjashtim nga çështja e materies së të drejtës penale

Edhe pse ndjeshëm i përmirësuar, edhe ky propozim-ligj gjithashtu ka të pathënat e veta, kështu që në atë drejtim Komiteti i Helsinkit së bashku me Fondacionin "Shoqërisë së Hapur" – Maqedonia, dhe rrjeti joformal i shoqatave "Qasja në Drejtësi në Republikë Maqedonia" përgatiti një dokument me komentet e mëposhtme, i cili ishte dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë:

1) Kuptimi i shprehjeve i propozim-ligjit të ri duhet të precizohet dhe duhet të përdoren shprehje juridike përgjithësisht të pranura për të shmangur paqartësinë dhe pa kuptueshmërinë e Ligjit.

2) Shtrirja e ndihmës juridike të mëparshme që është në kompetencën e të shoqatave dhe zyrave rajonale të Ministrisë të drejtësisë të jetë më e gjerë se informacioni i përgjithshëm, këshilli fillestar dhe plotësimi eventual i një kërkesë për ndihmë sekondare. Të lejohet që ndihma juridike e mëparshme të përfshijë shkrime të korrespondencave të thjeshta, si dhe zgjidhja paqësore të mosmarrëveshjeve dhe ndërmjetësim, me qëllim që të respektohen afatet e shkurtra që shpesh depërtohen derisa pritet një përgjigje ndaj kërkesës.

3) Propozim-ligji duhet të përmbajë dispozita me të cilat procedura para Gjykatës administrative kundër vendimit të Ministrisë së drejtësisë do të jetë urgjente, lëndët e tilla do të jenë urgjente dhe zbatuese, dhe zgjidhja e tillë ligjore do të garantohet.

4) Propozim-ligji duhet të përmbajë dispozita për mbikëqyrjen e punës pranë zyrave rajonale të Ministrisë të Drejtësisë, si dhe kriteret që personi zyrtar i autorizuar i punësuar në zyrën rajonale duhet ti plotësojë. Që shoqata të regjistrohet në regjistri e shoqatave për ndihmë juridike paraprake duhet të ketë punësuar të paktën një jurist me provim juridik, a ne llogarisim se të njëjtin kusht duhet të e plotësojnë edhe zyrat rajonale e Ministrisë së Drejtësisë, gjegjësisht në propozim-ligjin duhet të precizohen kushtet për një person që të jetë i punësuar si person zyrtar në zyrat rajonale.

5) Të fshihet pjesa në të cilën parashikohet akti themelues si kusht për marrjen e autorizimit, sepse akti i themelimit është akt i pandryshueshëm dhe shoqatat ekzistuese që ishin themeluar më parë, nuk kanë mundur të e definojnë dhënien e ndihmës juridike të mëparshme, në aktin e saj themelues.

6) Propozim-ligji duhet të parashikojë mbledhje elektronike e të dhënave dhe regjistrimin e kërkuësve dhe shfrytëzuesve të ndihmës juridike. Rrjeti joformal "Qasja në Drejtësi" zhvilloi bazë e të dhënave në të cilën futet secili kërkuës i cili ka kontaktuar shoqatat e autorizuara

Një zgjidhje e tillë i është ofruar Ministrisë të Drejtësisë, që në çdo moment të ketë qasje te personat dhe zonat për të cilat ata kërkohet NDF, afatet dhe të dhëna të tjera

7) Propozim-ligji duhet të specifikojë dhënien e ndihmës juridike jashtë-gjyqësorë. Veçanërisht e rëndësishme është, diskutohet i trashëgimisë që aktualisht rregullohet si një procedurë jashtë-gjyqësore përpara noterit, a sipas Ligjit për noteriatin, palët në procedurë duhet ti përfaqësojë avokat.

8) Propozim-ligji në dispozitat e tij nuk specifikon procedurën për përcaktimin e gjendjes financiare të kërkuësit dhe anëtarëve të familjes së tij me të cilën ai jeton në të njëjtën shtëpi. Nuk është e qartë si do të merren këto të dhëna nëse merret parasysh se Drejtoria e të ardhurave publike nuk jep të dhëna për të ardhurat për qytetarët për gjashtë muajt e kaluar, por për vitin e kaluar. Gjithashu nuk është sqaruar nëse do të merren parasysh bruto apo neto të

ardhurat të kërkuesit dhe anëtarëve të familjes së tij.

9) Shpjegim ose korrigjim i kushteve për pasurinë e kërkuesit në pjesën e kusht, kërkuesi dhe anëtarët e familjes së tij të posedojë vetëm një automjet, të cilin nuk e ka tjetërsuar në gjashtë muajt e fundit para paraqitjes së kërkesës për ndihmë juridike sekondare, sepse veç më është paraparë pragu i kursimet të kërkuesit dhe anëtarëve të familjes së tij, të cilat nuk duhet të kalojë dhjetë paga minimale neto.

10) Në pjesën e kushteve të tjera për aprovimin e ndihmës juridike sekondare duhet të specifikohen tjera kushte që duhet të i plotësoj personi që të marrë ndihmë juridike sekondare dhe në cilën mënyrë do të vlerësohet nëse janë plotësuar kushtet e tjera, që të definohen kriteret dhe provat të nevojshme për personin zyrtar, që të përcaktoj nëse plotësohen kushtet e tjera ose jo. Kushtet tjera janë, përcaktimi vallë nëse çështja juridike është e arsyeshme, vallë çështja juridike është e rëndësishme për statusin personal dhe socio-ekonomik të kërkuesit dhe familjes së tij dhe rezultati i pritshëm çështja juridike.

11) Propozim-ligji nuk ofron mekanizma për informim dhe edukim tëi qytetarëve për afatet që duhet ti respektojnë. Nuk është shpjeguar se cili është afati i fundit për dorëzimin në kohë të kërkesës të cilën personi duhet ta respektojë që të mos jetë e refuzohet. Gjetjet finale e hulumtimit mbi perceptimin publik dhe njoftueshmëria e qytetarëve me Ligjin për Ndhimën juridike falas, tregojnë se vetëm 32.6% e të anketuarve e dinë se çfarë është ndihma juridike falas, që do të thotë se një përqindje e lartë nuk është e njohur me këtë të drejtë e tyre, dhe saktësisht kjo është ajo që do të kontribuojë që një numër të madh i kërkesave të refuzohen për shkak të skadimit të afatit.. Prandaj, duhet pasur kujdes për informimin, por edhe për edukimin e qytetarëve, me theks të veçantë të afatit prej një dite, për paraqitjen e një kërkesë në procedurë urgjente.

12) Programi financiar i Ministrisë të Drejtësisë duhet për përfshijë edhe arsimim ligjor dhe përforcimin dhe njoftim me të drejtën e qasjes në drejtësi të qytetarëve. Ministria për drejtësi përveç programit financiar për ndihmë juridike, duhet të sjellë program në të cilin




do të parashikoj trajnime, kolegjiune dhe koordinim, mbikëqyrje, etj., me qëllim të njoftimit më të mirë më të kërkueseve potencial për ndihmë juridike falas, me këtë të drejtë të tyre. Programi i Ministrisë duhet të parashikojë aktivitete përmes të cilave kryhet përforcimi juridik dhe arsimim të grupeve të caktuara të marginalizuara. Është detektuar nevoja për përgatitjen e programës sipas të cilit do të punojnë shoqatat e autorizuara dhe zyrat rajonale të Ministrisë të Drejtësisë dhe mbi bazë të cilës do të ndiqet puna e tyre dhe do të u japë j udhëzime për përmirësim të shërbimit dhe qasjes ndaj qytetarëve. Programi i tillë duhet ti reflektojë gjendjet aktuale dhe ndryshimet që ndodhin në shoqëri dhe duhet të përgjigjet në nevojat juridike të të njerëzve.

13) Kundërvajtjet duhet të jenë përmbledhë nga propozim-ligji. Përveç asaj që përfaqësojnë punë administrative dhe zgjidhen në procedurë administrative para organeve administrative, propozuesi kundërvajtjet i ka vendosur në baza të refuzimit të kërkesës për ndihmë juridike sekondare. Është e nevojshme që Grupi punues të japë një shpjegim pse kundërvajtjet nuk janë të përfshira nga propozim-ligji si punë administrative për të cilat lejohet ndihma juridike sekondare.

14) Propozim-ligji duhet gjithashtu të rregullojë procedurat kur kërkuesit janë viktimat e dhunës në familje, si procedura urgjente. Në kontekstin e nevojës urgjente për sigurimin e ndihmë juridike për shkak të natyrës të problemit, ligji duhet të i përfshijë viktimat e dhunës në familje, dhe brenda 2 ditëve të ketë obligim të lëshojë vërtetim, pa kontrolluar gjendjen financiare të kërkuesit dhe anëtarëve të familjes së tij.

15) Propozim-ligji duhet të parashikojë se kur mundet pala të kërkoj nderimin e avokatit në rast se pala është e pakënaqur nga avokati i zgjedhur, gjegjësisht avokati nuk vepron në favor të klientit të tij, dhe donë që në vend të tij, të angazhoj avokat tjetër.

16) Propozim-ligji duhet të parashikoj një ilaç juridik në procedurat urgjente pas kërkesave në rast kur zyra rajonale e Ministrisë për drejtësi nuk do të veprojë pavarësisht urgjencës së procedurës, dhe kërkesa e paraqitur në kohë, përndryshe nuk mundet të garan-



tohet se zyrat rajonale do të veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore.

# LGBTI QENDRA E MBËSHTETJES

## ■ Hyrje

Kthesë është fjala që shënoi vitin e kaluar, pas nënvlerësimeve me dekada, dhe shkelja e vazhdueshme e të drejtave dhe lirive qytetare, me brutalitet të veçantë ndaj LGBTI Komunitetit. Me formimin e qeverisë së re, lidhshipi politik tregoi guxim dhe publikisht dhe me pa mëdyshje mbështeti luftën e njerëzve LGBTI për barazi, përfshirë edhe Kryeministrin i cili në festimin e ditëlindjes të LGBTI Qendra për Mbështetje, u angazhua gjithashtu për zgjidhjen e gjashtë rasteve të sulmit ndaj Qendrës. Gjithashtu përkrahje publike dhe me pa mëdyshje dha edhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale gjithashtu mbështetje dha edhe, Ministri i Kulturës dhe Ministri i Brendshëm, a me rëndësi të veçantë janë aktivitetet që kemi ndërmarrë me partnerët tonë për krijimin e një grupi parlamentar ndërpartiak për avancimin e të drejtave të personave LGBTI. Por tani për tani, shenjat e vetme për ndryshimi që e presim për një kohë të gjatë. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi edhe pse i paralajmëruar për fillimin e vjeshtës, ai nuk u miratua. Nuk kemi lëvizje në Kodin Penal, rreth veprimeve dhe gjuhës së urrejtjes, njohja juridike e gjinisë dhe shumë zgjidhje të tjera ligjore që janë urgjentisht të nevojshme për funksionimin e përditshëm të personave LGBTI. Fatkeqësisht, duhet të konstatojmë se vullneti i udhëheqjes politike, ende nuk mund ta shohim se ato kanë zbritur përmes strukturave të institucioneve shtetërore. Rastet e sulmeve ende nuk janë zgjidhur, ndryshime në ligjet në lidhje me të drejtat e personave LGBTI ende nuk. Ajo që në të vërtetë është pika më e ndritshme e vitit të kaluar, është angazhimi i vetë komunitetit LGBTI, veçanërisht në nivel lokal. Në vitet e fundit, janë formuar pesë bërthama lokale, nga të cilat katër janë ende funksionale dhe po përpiqen për të përmirësuar strukturën e tyre të brendshme, si dhe për të përforcuar kapacitetin e tyre për vetë-qëndrueshmëri. Lufta e tyre, gjithashtu është edhe sfida e jonë në periudhën që vijon. Edhe shumë informacione të tjera janë të përfshira në raportin vjetor, në të cilin edhe në detaje do të mund të njoftoheni me aktivitetet që vetë Qendra i ka realizuar vitin e kaluar.

## ■ Programi i përfaqësimit

Gjatë vitit 2017, Qendra e Mbështetjes LGBTI krijoi një program të ri për përfaqësim. Në bashkëpunim të ngushtë me disa deputetë, të cilët veç më janë të angazhuar në promovim dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave LGBTI edhe me organizatat partnerë, Qendra ishte e përfshirë në procesin e themelimit të grupit ndërpartiak parlamentar për avancimin e të drejtave të personave LGBTI. Prioritetet e punës të grupit, i përmbledhin ndryshimet ligjore që duhet të zbatohen me qëllim të përmirësimit, e të drejtave të personave LGBTI në Maqedoni, dhe përafrimi i legjislacionit maqedonas me konventat ndërkombëtare që vendi i ka ratifikuar, si pjesë e ndryshimeve ligjore prioritare, ishte detektuar ligji për të parandaluar dhe mbrojtur nga diskriminimi, për të cilin përfaqësimi lëviz në drejtim të futjes e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë për diskriminim. Propozim-ligji final që duhet të miratohet në vitin 2018 i përfshin, edhe, orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë për diskriminim, por nuk i përfshin edhe karakteristikat gjinore, Me çka njerëzit ndër-seksualë mbeten ende në margjinat e shoqërisë. Për Krahas kësaj, propozim-teksti i Ligjit parashikon dhe diskriminim të shumëfishtë dhe ndërseksional, i cili shumë shpesh paraqitet tek personat LGBTI.

Gjithashtu gjatë vitit 2017 në konferencën finale rajonale nikoqir i të cilës ishte Qendra LGBTI për herë të parë në një ngjarje të LGBTI mori pjesë edhe një Ministër i Brendshëm, dhe në fjalën e tij theksoi rëndësinë e ndryshimit të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, me përfshirjen e orientimit seksual dhe identiteti gjinor si baza për veprat dhe gjuhën nga urrejtja.

Përveç përdorimit të mekanizmave kombëtarë, gjatë vitit 2017, Qendra LGBTI gjithashtu i shfrytëzonte mekanizmat e Kombeve të bashkuara në përpjekje për të përmirësuar statusin e pakicave seksuale dhe gjinore dhe me përfaqësuesen e veten i paraqiti nevojat dhe problemet e lezbikeve, gratë biseksuale dhe njerëzit trans gjinor nga Maqedonia, vendet e Ballkanit perëndimor dhe Turqia, në një ngjarje paralele gjatë Komisionit për status të grave pranë Kombeve të Bashkuara.

## ■ Programi për komunitetin

Situata e ndryshuar politike gjatë vitit 2017 çoi në aktivitet më të madh të personave LGBTI sa i përket vete përfaqësimit për të ndryshuar statusin social dhe ligjor në të cilin gjinden. Arritëm sukses në përpjekjet tona për decentralizimin e LGBTI lëvizjeve jashtë kufijve të Shkupit, dhe deri më tani kemi zhvilluar 5 LGBTI bërthama lokale në 5 qytete në të gjithë Maqedoninë: Prilep / Manastir, Tetovë, Kumanovë, Strumicë dhe Suto Orizari, të cilët punojnë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e LGBTI njerëzve në komunat e tyre. Anëtarët e bërthamave janë shumë të larmishëm, që vijnë nga mosha, gjini, fe dhe përkatësi etnike të ndryshme.

Grupet e Mbështetjes së Qendrës (Grupi i Mbështetjes së Gay-ve burra, grupi lezbiko-feminist për mbështetje, grupi për mbështetje për njerëzit trans gjinorë dhe një grup mbështetësish i personave LGBTI) organizuan 60 ngjarje: takime të rregullta, klube leximi, diskutime, shfaqje filmash dhe ngjarje sociale. Organizimi i komunitetit dhe të qenit i sigurt dhe ekzistimi i hapësirave të sigurta ku personat LGBTI do të jenë të lirë, do të ndajnë përvojat e tyre, do të marrin mbështetje dhe forcë, është thelbësore rëndësia për të siguruar mirëqenien e komuniteteve LGBTI, sido mos për ata që jetojnë në një mjedis më armiqësor. Gjatë viti 2017 Qendra ishte e hapur çdo ditë për anëtarët e komunitetit. Shfaqjet e filmave LGBTI dhe queer temat si pjesë e programit të ndërtimit të komunitetit, gjithashtu u zhvillua gjatë vitit 2017. Në vitet e mëparshme të funksionimit të Qendrës, kjo u vërtetua të ishte një mjet i përshtatshëm për depërtimin e diskurseve jo-heteroseksuale në hapësirën publike, i cili edhe ashtu është i përmblytur me normativet heteroseksuale. Gjatë vitit 2017, LGBTI Qendra organizoi 6 shfaqje të hapura dhe 4 shfaqje të mbyllura (për gratë LBT).

Nga 22 e deri më 25 Qershor të vitit 2017, u zhvillua Fundjava e pestë e Krenarisë- TRANS-FORMACIONET, organizuar nga ana e koalicionit "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara", Qendra për mbështetje LGBTI, dhe LGBT Junajted Tetovë. Interesi i madh për Javën e Krenarisë u shpreh që nga vet para ngjarja ku morën pjesë më shumë se 350 njerëz, ndërsa videoja e ngjarjes kishte më shumë se

7000 shikime. Fundjava e Krenaria zyrtarisht u hap më 22 qershor me një fjalim nga Ministri i Kulturës, z. Robert Alagjovovski në të cilin ai e shprehu mbështetjen e tij për lëvizjen LGBTI në vend.

## ■ Shelter Qendra - Shtëpi e sigurt

Që në fillim, LGBTI Qendra e Mbështetjes, e cila vepron brenda Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë. Maqedonia i ndihmon personat e LGBTI komunitetit në raste urgjente, por zgjidhjet e deriatëhershme ishin afatshkurte dhe nuk mundeshin t'i plotësojnë nevojat në mënyrë gjithëpërfshirëse të viktimave. Prandaj, Qendra LGBTI vendosi të hapë sportel-qendër - Shtëpi e sigurt, e cila do të vihet në veprim në shërbim të drejtpërdrejtë për këtë kategori të marginalizuar dhe të prekshme qytetarëve, me qëllim që t'i mbrojë ata nga çdo lloj dhune, ndihmë në situata krize, si edhe ndihmë më afatgjate, ri integrim dhe risocializim.

Shelter Qendra shtëpia e sigurt, zyrtarisht fillon të funksionojë në maj të vitit 2017, dhe ligjërisht është regjistruar si një filiale e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë.

Një pjesë e stafit trajnohet nga shelter qendra e strehimit partner për LGBTI viktimat e dhunës nga Tirana, Shqipëri. Gjithashtu, këshillimi i stafit ishte sigurua nga Albert Kennedy Fondacioni Trust nga Britania e Madhe. Qendra LGBTI për mbështetje siguroi një sërë trajnimesh për sensibilizim të stafit për punë me këtë kategori të marginalizuar dhe të prekshme të njerëzve.

Shërbimet e Shtëpisë së Sigurt përfshijnë, mbështetje psiko-sociale, këshilla juridike falas dhe trajnim socio-arsimor për gatishmëri për punë dhe aftësi praktike të jetës. Njësoj kështu, gjatë vitit 2017, puna e Shtëpisë së Sigurt ka përfshirë programe rekreative dhe kreative dhe punëtori, qëllimi i të cilave ishte të i ndihmonte shfrytëzuesit e shërbimeve të Shtëpisë së sigurt për të mësuar aftësi të reja, për të mbushur kohën dobishëm dhe të përgatiten për një jetë më të mirë individuale, pas lëshimit të shelter qendrës.

Në vitin e kaluar, Shelter qendra Shtëpia e Sigurt bëri gjithsej 9 akomodime për 7 përdorues, me të njëjtit janë bërë gjithsej 17 seanca psikologjike, individuale dhe grupore. Njësoj kështu që, atyre u është ofruar ndihmë juridike falas dhe ndihmë në fushën e mbrojtjes sociale.

# REKOMANDIME

## Gjyqësori

- Punë transparente dhe gjithëpërfshirëse e Këshillit të monitorimit zbatimin e Strategjisë së reformës në sektorin gjyqësor.
- Forcimi i pavarësisë së gjyqësorit përmes transparencës në vendimet për emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe të prokurorëve publik.
- Përcaktimi i kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit gjyqësor.
- Vendosje e mekanizmave të llogaridhënies për anëtarët e Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik.
- Vendosja e praktikës e vendimeve qartë të arsyetuara të Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publik për përgjegjësi disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve / prokurorëve publik.
- Sqarimi i arsyeve për përgjegjësinë e gjyqtarëve.
- Zbatim i qëndrueshëm i kodeve të etikës nga gjyqtarët dhe prokurorët publik, veçanërisht kur bëjnë deklaratë publike.
- Sigurimi i shpërndarjes së paanshme të lëndëve përmes kontrollit të rregullt dhe revizionit të sistemit AKMIS.
- Ekzekutimi më i koordinuar i vendimeve të Gjykatës së Evropës për të drejtat e njeriut.

## Lufta kundër korrupsionit

- Zbatim i qëndrueshëm i dispozitave të Ligjit për Parandalimin e korrupsionit nga ana e komisioni Shtetëror për parandalimin të korrupsionit.



- Zhvillimi i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve kompetente për parandalimin e korrupsionit dhe organizatat qytetare.
- Rritja e transparencës së komisionit Shtetëror për parandalimin e korrupsionit përmes publikimit të rregullt të vendimet e tyre.

## Trajtim i barabartë

- Miratimi i një ligji të ri dhe të përmirësuar për mbrojtjen dhe parandalimin nga diskriminim me të cilin do të mundësohet mbrojtje më e mirë dhe më efikase nga diskriminimi.
- Futja e veçimit si një formë e veçantë e diskriminimit
- Shteti duhet të zhvillojë më shumë fushata informimi për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e diskriminimit, format e manifestimit dhe mekanizmat mbrojtëse nga diskriminimi.
- Komisioni i Forcuar për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmes ndryshimit të kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit dhe vendosja e një shërbimi ekspert (Sekretariati) i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi.
- Avokati i Popullit duhet më shpesh të përdorë kompetencat ligjore për të nisur procedurat sipas detyrës zyrtare në rastet e diskriminimit ku preken më shumë persona.
- Shteti të përmirësojë qasjen deri te mbrojtja gjyqësore përmes ndryshimeve në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, me dispozita që do të parashikojnë përjashtimin nga taksat gjyqësore për personat të cilët do të nisin procedurë gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi.
- Prokuroria publike të përmirësoj efikasitetin dhe të filloj të veprojë në lidhje me akuzat penale për diskriminimit dhe gjuhës të urrejtjes.
- Qasje proaktive e organeve të barazisë dhe organeve të tjera dhe institucione që kanë autorizimin për të vepruar në rastet të diskriminimit.

## Gjuha e urrejtjes

- Figurat publike, politikanët, gazetarët, profesorët universitar dhe ekspertë dhe persona të tjerë që kanë rol të rëndësishëm në procesin e krijimit të opinionit publik jo vetëm që është e nevojshme të përmbahen nga përhapja e gjuhës së urrejtjes, por duhet ta dënojnë publikisht dhe të tregojnë zero tolerancë për gjuhën të urrejtjes.
- Organet kompetente për ndjekje, Ministria e punëve të brendshme, prokuroritë publike dhe gjykatat duhet të tregojnë pro aktivitet dhe luftë serioze kundër gjuhës së urrejtjes përmes përcaktimit e përgjegjësisë penale të kryerësve dhe dënimit të tyre të duhur.
- Media duhet të raportojë në mënyrë objektive, të paanshme dhe me respekt absolut për standardet gazetareske dhe kodin e etikës, me çka do të pamundësohet përhapja e gjuhës të urrejtjes dhe paragjykimin ndaj të pambrojturve dhe grupeve shoqërore. Në të njëjtën kohë, mediat tradicionale dhe internet-mediat duhet të kenë vetëdije dhe përgjegjësi më të madhe në largimin e komenteve me gjuhë të urrejtjes në internet platformat e tyre, të cilat devijojnë nga liria e shprehjes.
- Të Nevojshme janë masa për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për grupet e cenueshme, të marginalizuara dhe pasojat e dëmshme të gjuhës së urrejtjes kundër individit dhe grupit të cilit ai i përket.
- Urgjentisht dhe menjëherë të largohen mbishkrimet me gjuhë të urrejtjes së shkruar në vend publik. Obligimi për largimin e tyre është në duart e institucioneve shtetërore, të cilat duhet t'i respektojnë vazhdimisht.

## Veprat e urrejtjes

- Të merren parasysh përvojat e shteteve anëtare të BE në zgjerimin në kornizat brenda legjisllacionit të tyre penal shtrirjen/ diapazo-

nin e veprave të dënueshme nga urrejtja dhe përfshirja e motiveve të tjera të njëanshmërisë prapa këtyre veprave;

- Të sigurohet hetim dhe ndjekje e shpejtë, e azhurnuar dhe efektive të veprave nga urrejtjes duke garantuar se motivet e njëanshme janë marrë parasysh edhe gjatë procedurës penale;
- Duhet të merren masa të përshtatshme që të ndihmohet raportimi i veprave nga urrejtja nga ana e viktimave, përfshirë masa që të ndërtohet besimi në polici dhe në institucione tjera shtetërore;
- Të mblidhen dhe të publikohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për veprat nga urrejtja, sa më shumë që të jetë e mundur duke përfshirë edhe për numrin e incidenteve të tilla të raportuara nga opinioni dhe të regjistruara nga organet e zbatimit të ligjit; Numri i dënimeve; motivet e njëanshme prapa atyre krimeve; dhe ndëshkimet e shqiptuara ndaj autorëve;
- Të sigurohet që viktimat e veprave nga urrejtja janë të përkrahur dhe të mbrojtur;
- Të përparohet trajnimin e praktikuesve relevant të cilët hyjnë në kontakt me viktimat e veprave nga urrejtja, dhe kështu duke ju mundësuar atyre që të ndihmojnë në mënyrë efektive këto viktimat; dhe
- Të forcohen masat parandaluese, mes tjerash edhe përmes reflektimit të edukimit për të drejtat e njeriut, planet mësimore nga historia dhe trajnimet përkatëse, ndërmarrje hapa për edukimin e opinionit për vlerat e diversitetit kulturor dhe përfshirja, me qëllim që të gjithë sektorët shoqëror të kenë rol të caktuar në luftën e një jo tolerancë të tillë.

# INSTITUCIONE TË MBYLLURA

Reforma e shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës, me një fokus të përgjimit të komunikimeve

- Ndryshimi i modelit të parashikuar me atë që operatorët e telekomunikacionit do të jenë ata që do të ridrejtojnë komunikimet tek autoritetet kompetente për përcjelljen e komunikimeve me urdhër të mëparshëm të gjykatës, dhe vetëm për qëllimin e përcjelljes ligjore;
- parashikim i masave serioze teknike për tu parandaluar mundësia e devijimit të mëtejshëm të komunikimit në palë të treta të paautorizuara, si dhe parashikimi i dënimeve të ashpra për personat e autorizuar në organin ndërmjetës dhe në organet e autorizuar për përcjellje të komunikimeve nëse do të performonin devijim i tillë;
- Heqja e “masave për përcjellje të komunikimeve” nga Ligji për përcjelljen e komunikimeve, e që është kompetencë e LKp;
- Ridefinimi i dispozitat në lidhje me mbledhjen dhe ruajtja e mega të dhënave;
- heqjen e kompetencave që i prokurorit publik, pasi ato nuk janë në përputhje me kompetencat e prokurorit publik në Ligjin për procedurën penale dhe me kapacitetet e prokurorisë publike në tërësi;
- Përforcimin e kapaciteteve të mekanizmave për kontroll dhe mbikëqyrje mbi përcjelljen të komunikimeve;

## IP Enti special - Demir Kapija

- Procesi i de institucionalizimit të këtij institucioni duhet të jetë prioritet në vitin e ardhshëm dhe të vazhdojë me ritëm të intensifikuar dhe sipas një plani aksionar të përgatitur më parë.

- Derisa të përfundojë procesi i de institucionalizimit, doemos të garantohet mbrojtja shëndetësore e të mbrojturve. Për këtë qëllim, duhet të rritet numri i mjekëve specialistë, përfshirë edhe internistët e përhershëm (mjek i përgjithshëm, gjinekolog dhe dentist) në Entin Special IP-së Demir Kapija të cilët në kontinuitet, në bazë ditore do të e ndjekin gjendjen shëndetësore të pacientëve dhe si pacientët, do të mund t'i realizojnë të gjitha të drejtat nga sigurimi shëndetësor.

# Grupet e ndjeshme

## Personat me aftësi të kufizuara

- Në mënyrë që të sigurohet qasje për personat me aftësi të kufizuara në mjedisin e përgjithshëm shoqëror, është e nevojshme të ndërtohet një sistem gjithëpërfshirës për heqjen e pengesave dhe vendosjen e shërbimeve me precizin konkret të instrumenteve për kontrollë dhe koordinimin e mikro dhe makro nivel.
- I nevojshëm është vlerësimi dhe zhvillimi plotësues i mëtejshëm dhe futja e serviseve dhe shërbimeve të reja (të tilla si futja e ndihmës personale, rehabilitimi profesional dhe dobësimi). Futja e tyre duhet të shoqërohet me krijimin e profileve përkatëse që do të plotësojnë nevojat e qytetarët me aftësi të kufizuara.
- Përcaktimi i kostos së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.
- Tejkalimi i qasjes mjekësore në vlerësimin e aftësive (kategorizimit) të personave me aftësi të kufizuara. Në atë drejtim, është e nevojshme të futet modeli i vlerësimit të aftësive sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të funksionalitetit, shëndeti dhe aftësia e kufizuar - ICF, si një kornizë për futjen e modelit social. I njëjti duhet të jetë ngushtë i lidhur me rrjetin potencial të shërbimeve mbështetëse të familjes, gjegjësisht vlerësimi i aftësive duhet të jetë e themeluar për aktivitete zhvillimore dhe plan për secilin fëmijë dhe person me aftësi të kufizuar.
- Ristrukturimi i vendosjes institucionale të sistemit të mbrojtjes sociale në drejtim të ndarjes të administrimit të drejtë në ndihmë financiare dhe shërbimet sociale.
- Miratimi i politikave të strehimit për qytetarët me pengesa fizike duhet të jetë në mënyrë që të sigurojë jo vetëm shtëpi, por edhe kushte adekuate të strehimit dhe një shtëpi të përballueshme si parakusht për përfshirje sociale.

- Futja e masave që do të promovojnë studimin e gjuhës të shenjave, si dhe marrja e masave për të siguruar një numër më të madh të interpretuesve të gjuhës së shenjave. Plotësisht, e nevojshme është të rregullohet çështja e përdorimit të alfabetit Braill, siç futja e dispozitave që do ta stimulonin studimin e alfabetit Braill.
- Për personat e verbër, duhet të sigurohet shërbimi "trajnimi për orientim në hapësirën mikro dhe makro për të verbrit".
- Barazimi i kompensimeve që u jepen familjeve kujdestare dhe familjeve biologjike. Rishikimi i sistemit të mbështetjes së institucioneve dhe format jashtë institucionale të mbrojtjes, në drejtim të punës së tyre në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.
- E nevojshme është futja e një sistemi statistikor që do të mundësojë ekzaminim të saktë dhe transparent të personave me aftësi të kufizuara në lidhje me shërbimet sociale dhe serisë që ata i përdorin sipas të gjitha karakteristikave demografike.
- Krijimi i shërbimeve të rehabilitimit mjekësor dhe habitim dhe të shërbimeve me cilësi dhe të drejtë të barabartë të zgjedhjes..
- Edukimi dhe trajnimi i detyrueshëm i personelit shëndetësor, përfshirë edhe shërbimet patronazhe, për qasje dhe komunikim me qytetarët me aftësi të kufizuara.
- Sigurimi i qasjes dhe aksesit të papenguar në të gjithë objektet shëndetësore, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Fondin e Sigurimit Shëndetësor, të gjitha institucionet shëndetësore publike, si dhe klinikat, spitalet, shtëpitë e shëndetësisë, entet, ordinancat, barnatoret, etj.
- Identifikimi sistematik, evidentimi dhe përcjellja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të rregullohet me akte ligjore dhe nënligjore. Ky proces duhet të lidhet me reformën e procesit të verifikimit të llojit dhe shkallës të aftësisë së kufizuar, në përputhje me klasifikimin ndërkombëtar të funksionalitetit, aftësi e kufizuar dhe shëndet.
- Të sigurohen mjete të mjaftueshme buxhetore për mbështetjen e

përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt.

- Të sigurohet qasje e plotë fizike deri te objektet shkollore, në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë edhe ambientet e brendshme dhe pajisja me mjete didaktike dhe mjete tjera të nevojshme dhe materiale për mësimdhënie gjithëpërfshirëse.
- Të parashikohet përdorimi i teknologjisë moderne të informacionit dhe komunikimit si një mjet për përfshirjen arsimore, përfshirë zhvillimin e aplikacioneve arsimore të arritshme në internet gjuhëve të mësimin në Maqedoni, për zotërimin më të lehtë të përmbajtjeve mësimore.
- Librat dhe materialet tjera arsimore, të sigurohen në gjuhën Braille, në audio format dhe / ose në përputhje me standardet për qasje në internet. Me akte ligjore ose nënligjore duhet të parashikohet kusht që autorët të gjitha materialet të i dorëzojnë tek MASH, në formë elektronike, në përputhje me standardet ndërkombëtare për qasje në internet.

## Romët

- Zgjerimi i qasjes në arsimin parashkollor. Është e nevojshme të sigurohet të paktën një vit falas arsimit parashkollor në grupe të përziera etnikisht. Transporti gjithashtu duhet të sigurohet gjatë gjithë vitit kalendarik.
- Sigurimi i mbështetjes arsimore jashtë orëve të shkollës Futja e programeve jashtëshkollore për ndihmë në shkrimin e detyrave të shtëpisë dhe mësim shtesë për lëndët kyçe.
- Aktivitetet në nivelin kombëtar duhet të bëjnë që proceset e testimit të fëmijëve për përfshirje në arsimimin fillor të jenë kulturorisht më të ndjeshëm, me qëllim që të zvogëlohet numri i romëve në shkolla speciale. Ri integrimi (në arsimin standard) i fëmijëve të cilët janë regjistruar në mënyrë joadekuate në arsimin special të plotësohet me punë në terren në nivel të bashkësisë lokale komu-



niteti për të rritur ndërgjegjësimin në mesin e familjeve romë në lidhje me mangësitë në arsim dhe kufizimet e mundësive të karrierës që lindin nga regjistrimi i fëmijëve pa nevoja të veçanta në shkolla për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

- Hetimi dhe adresimi i diskriminimit në arsim. Frekuenca e ndarjes dhe më shumë ose më pak forma tjera suptile të diskriminimit në arsim duhet të dokumentohet në mënyrë sistematike si bazë për përgatitjen e masave të përshtatshme për zgjidhjen e tyre, me gjetje të përcjella në Ministrinë e Arsimit dhe shkencës për mbledhjen dhe përcjelljen e përshtatshme. Përveç pyetjeve lidhur me diskriminimin ndaj romëve nga ata që nuk janë romë, vëmendja duhet t'i kushtohet dallimeve gjinore në nivelet e përfundimit të arsimit të detyrueshëm, a martesat nën moshë duhet të trajtohen si dëmtim mbi të drejtat e vajzave romë.
- Gjatë regjistrimit të nxënësve në klasën e parë, shkollat dhe pushtetet komunale të kenë kujdes për numrin e nxënësve romë dhe përshtatshmërinë dhe ekuilibrin e vendosjes të tyre midis nxënësve nga një komunitet tjetër etnik.
- Përgatitja e një ligji për strehimin social.
- Të "degetoizohen" vendbanimet romë, gjegjësisht të investohet në ndërtim të ndërtesave të banimit dhe qasjen për banesa sociale për romët jashtë vendbanimit ose në afërsi ku ka kushte adekuate për banim dhe qasje në jetë cilësore

## Punëtoret e tekstilit

- Është e nevojshme të ndryshohet Ligji për pagën minimale me shfuqizimin e dispozitave që parashikojnë dhe rregullojnë ekzistimin e një performance të standardizuar.
- Shteti duhet të përmirësojë qasjen në drejtësi për punëtoret dhe punëtorët e tekstilit, përmes përmirësimit të efikasitetit të mekanizmave mbrojtëse dhe zvogëlimin e shpenzimeve gjyqësore

dhe të avokatit në procedurat gjyqësore për mosmarrëveshjet e punës, me qëllim për mbrojtje më të mirë dhe më efkase e të drejtave të tyre punëtore.

- Punëdhënësit në industrinë e tekstilit, lëkurës dhe këpucëtarisë duhet të përmirësojë kushtet e punës me implementimin e standardeve minimale për kushtet, sigurinë dhe shëndetin në punë në përputhje me standardet vendase dhe standardet ndërkombëtare, përfshirë standardet e organizatës ndërkombëtare të punës.

## Ndihmë juridike falas

- Prioretizimi i ndryshimeve në Ligjin për ndihmën juridike falas, me qëllim që në afat sa të jetë e mundur më të shpejtë në procedurë parlamentare dhe të hyjë në fuqi.
- Pranimi i vërejtjeve dhe komenteve mbi Ligjin për ndihmë juridike falas të dhëna nga shoqatat e autorizuara për të siguruar tekst ligjor më të qartë dhe më cilësor.
- Respektimi i afatit të përcaktuar ligjërisht në Ligjin për ndihmë juridike falas nga zyrat rajonale të Ministrisë të Drejtësisë dhe gjetja e mekanizmave për mbrojtjen e qytetarëve në rast të tejkalimit të afatit nga ana e autoriteteve kompetente;
- Parashikim i mekanizmave institucionale për shkrim-lexim, fuqizim dhe njoftim të qytetarëve me të drejtën e qasjes në drejtësi;

## Migrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit

- Urgjentisht dhe menjëherë të ndërpritet praktika e “dëbimi” jo legal dhe grupor të refugjatëve dhe migrantëve në vendet fqinje, pa bashkëpunim të vendosur ndërkufitar me shërbimet e sigurisë.

Ajo përfaqëson shkelje e të drejtave themelore dhe lirive të njeriut të migrantëve dhe trajtimi johuman. Të gjitha procedurat e kthimit (Riad misionit) duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut dhe të implementuar në bashkëpunim midis shteteve.

- Në kohë sa më të shpejtë të miratohet Strategjia Kombëtare për integrimi të refugjatëve dhe të huajve (2017-2027), i cili do mundësojnë zbatimin sa më të shpejtë të masave të integrit të parashikuara në planin e aksionar, dhe do të kontribuojnë në rritjen e respektimit të të drejtave të refugjatëve të njohur dhe azilkërkuesve në vend.
- Në kohë sa më të shpejtë të sillet ligji i ri për mbrojtje ndërkombëtare dhe të përkohshme, me të cilin nuk do të jenë në fuqi ndryshimet ligjore të këqija dhe kufizimet e miratuara në vitin 2016.
- Të vendoset një sistem për regjistrimin i të gjithë refugjatëve dhe migrantëve, që tranzitojnë nëpër shtet, të jetë i rregullt, në kohë dhe rregullar, me qëllim që të përcillet lëvizja e tyre dhe të zmadhohet mundësia për mbrojtjen e të drejtave të tyre të njeriut.
- Nevojiten masa për të ndikuar në opinionin publik për krizën refugjate, duke pasur parasysh nivelin e lartë të vërejtur të ksenofobisë midis qytetarëve, mosnjohja e të drejtave të refugjatëve dhe migrantëve, arsyet e arratisjes së tyre dhe problemet me të cilat përballen. është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi i opinionit dhe qasja në informacionet për krizën, gjë që do të ulte jo tolerancën dhe gjuhën e urrejtjes.
- Trajtimi policor i refugjatëve duhet të bëhet në përputhje me ligjet dhe standardet kombëtare, në përputhje me parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut të refugjatëve dhe migrantëve. Të gjitha aksionet e policisë ku përdoret forca fizike ose mjetet e detyrimit, duhet të mbikëqyre në mënyrë rigoroze. Të gjitha akuzat për përdorimin e tepruar të forcës nga oficerët e policisë duhet të hetohen tërësisht dhe oficerët e policisë të mbajnë përgjegjësi.
- Ekziston një nevojë e konsiderueshme për mbikëqyrje të shtuar mbi të miturit e pashoqëruar që tranzitojnë nëpër vend dhe gjen-

den në dy kampet e pritjes-tranzitit. Ata janë në të ekspozuar në rrezik serioz dhe janë në një pozitë të prekshme dhe nuk guxon të jenë të lënë pa mbikëqyrje dhe pa mbrojtje nga sistemi.

- Aktivitete arsimore dhe rekreative brenda qendrave të pritjes-tranzitit duhet të zhvillohen pa marrë parasysh numrin e migrantëve, moshën e tyre ose statusin në shtet. Ministria e Arsimit duhet të sigurojë programe të përshtatshme, për të mos ju lënë vetëm organizatave qytetare.
- Nuk guxon të praktikohet lëshimi selektiv i refugjatëve në qendrat e pritjes-tranzitit. Ndihma humanitare dhe mbrojtja nga rreziqet e sigurisë duhet të ju sigurohen të gjithë refugjatëve dhe migrantëve që lëvizin nëpër vend, me qëllim që të shmanget vënia e tyre në rrezik shtesë.
- Refugjatëve dhe migrantëve që kalojnë nëpër shtet, nuk guxon të ju kufizohet liria e tyre e lëvizjes, dhe në mënyrë të paligjshme të mbahen në paraburgim në cilësinë e dëshmitarëve në procedurat penale kundër kontrabandistëve.
- Të rritet e prania së oficerëve të policisë në qendrat e pritjes-tranzitit, me çka do të garantohet siguria e të gjithë të pranishmëve në kampe.

# Qendra e Mbështetjes LGBTI

## programi i përfaqësimit

- Krijimi i një Grupi Parlamentar Ndërpartiak për LGBTI, është një hap i madh përpara në luftën për të përparuar të drejtat njerëzve LGBTI, dhe Qendra LGBTI shpreson për intensitetet të procesit të përfaqësimit për ndryshimet ligjore me qëllim të përmirësimit të statusit e njerëzve LGBTI.
- Qendra LGBTI e përshëndet futjen e orientimit seksual dhe identiteti gjinor në propozim-ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe apelon që ligji të miratohet me këto baza në mënyrë që të përmirësohet mbrojtja ndaj personave LGBTI nga diskriminimi.
- Qendra LGBTI apelon për nevojën e ndryshimit të Kodit Penal, duke përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza për veprime dhe gjuhë nga urrejtja.

## programi i komunitetit

- Ne apelojmë për nevojën për përfshirje të plotë të personave LGBTI në krijimin e politikave si kombëtar ashtu edhe në nivelin lokal, duke marrë parasysh nevojat dhe problemet me të cilat përballlet ky komunitet.
- E rëndësishme është nevoja për të krijuar hapësira të sigurt në nivel lokal, ku personat LGBTI do të socializohen, do të krijojnë dhe formojnë bërthama të rezistencës kundër stigmës dhe diskriminimit të bazuar në orientimin seksual dhe / ose identitetin gjinor.
- Ne apelojmë deri te pushtetet kombëtare dhe lokale për më shumë pro aktivitet në bashkëpunimin me njerëzit dhe organizatat

LGBTI që e përfaqësojnë këtë komunitet në drejtim të përmirësimit të statusit të personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë, si dhe përfshirja e tyre e plotë në rrjedhat shoqërore.

## Qendra e Strehimit - Shtëpia e Sigurt

- Është i domosdoshëm sensibilizimi i punonjësve në institucionet publike, që ata të mundën të përgjigjen në mënyrë adekuate në kërkesat e popullatës LGBTI, me çka ata do të merrnin trajtim të barabartë dhe zbatimin e ligjeve njësoj si edhe për pjesën tjetër të popullsisë
- Resurset që janë në dispozicion të personave LGBTI që janë viktime të dhunës ose në rrezik të pastrehësisë, për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të ekzistencës të tyre, ata kërkojnë financim të qëndrueshëm. Gjegjësisht, për resurse të këtilla duhet të ndahen mjete shtetërore në nivel vjetor.
- Shelter qendrat në nivel global, mbeten në fazat e hershme të zhvillimit. Një nga rekomandimet është të investohet në edukim shtesë të stafit, dhe të punohet në programe të përshtatura për nevojat e personave LGBTI.

